



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.150

dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9663 datë 18.12.2006	Për koncesionet.....	6075
Ligj nr.9665 datë 18.12.2006	Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë.....	6088
Ligj nr.9667 datë 29.12.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar.....	6100
Ligj nr.9668 datë 18.12.2006	Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi...	6101
Ligj nr.9669 datë 18.12.2006	Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.....	6113

LIGJ
Nr. 9663, datë 18.12.2006

PËR KONCESIONET

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionare.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ofertuesi” ose “Ofertuesit” janë subjekte juridike ose bashkime të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë apo që marrin pjesë në një procedurë përzgjedhjeje, në lidhje me një koncesion.

2. “Procedurë konkurruese e përzgjedhjes” është procedura për përzgjedhjen e koncesionarit, në përputhje me nenet 10 deri 21 të këtij ligji.

3. “Koncesion” është marrëveshja, pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari:

a) realizon një veprimtari ekonomike që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike;

b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;

c) merr një përfitim nëpërmjet:

i) pagesave të drejtpërdrejta nga autoriteti kontraktues apo për llogari të këtij të fundit;

ii) tarifave ose pagesave, që mblidhen nga përdoruesit ose blerësit;

iii) një ndërthurjeje të këtyre tarifave dhe pagesave të drejtpërdrejta.

4. “Koncesionar” është personi juridik, shqiptar ose i huaj, me ose pa pjesëmarrje vendase apo të huaj, që lidh një kontratë koncesioni me një autoritet kontraktues.

5. “Regjistër koncesioni” është regjistri i mbajtjes së të dhënave për procedurën e përzgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit, që mbahet nga autoriteti kontraktues dhe që, në fund të procedurës, depozitohet në Agjencinë e Prokurimit Publik. Forma dhe mënyrat e mbajtjes përcaktohen nga kjo agjenci.

6. “Autoritet kontraktues” është autoriteti publik, që ka përgjegjësinë të lidhë kontratë koncesioni.

7. “Mjete infrastrukturore” janë sistemet dhe asetet fizike që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kryejnë shërbime publike.

8. “Projekt koncesioni” është secila nga veprimtaritë e mëposhtme apo çdo ndërthurje e tyre, si: projektimi, ndërtimi, zhvillimi i mjeteve të reja të infrastrukturës, rehabilitimi, modernizimi apo zgjerimi i mjeteve të infrastrukturës ekzistuese; administrimi, zgjerimi apo shërbime të tjera, që lidhen me mjetet e reja apo ekzistuese të infrastrukturës.

9. “Licencë” është një akt administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kritere objektive të kualifikimit.

10. “Koncesione vendore” janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike që, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësisë të qeverisjes vendore.

11. “Koncesione shtetërore” janë koncesionet për ato veprimtari ekonomike që, në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, janë kompetencë e njësisë të qeverisjes qendrore.

12. “Propozim i pakërkuar” është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, brenda kontekstit të një procedure përzgjedhëse konkurruese.

13. “Investim privat” është propozimi, i financuar dhe i realizuar tërësisht nga sektori privat, ku sektori publik nuk merr pjesë drejtpërdrejt apo tërthorazi. Për efekt të këtij ligji, çdo lloj garancie, financiare apo e ndonjë forme tjetër, e dhënë nga sektori publik, vlerësohet si pjesëmarrje e këtij sektori në investimin privat.

14. “Agjencia e Prokurimit Publik” është agjencia e ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

15. “Avokati i Prokurimeve” është institucioni i ngritur dhe që funksionon sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

16. “Bashkim i përkohshëm i shoqërive” është marrëveshje e shkruar ndërmjet dy ose më shumë personave juridikë, që ka për objekt kryerjen e një veprimtarie të caktuar, ku përcaktohet roli i secilës palë dhe ku njëra prej tyre përcaktohet si shoqëri kryesuese, që përfaqëson bashkimin në nënshkrimin e kontratës dhe në çdo nismë tjetër.

17. “Vlera për para” është një term, që përdoret për të përcaktuar nëse një autoritet kontraktues ka arritur përfitimin maksimal nga mallrat apo shërbimet, që merr dhe/ose jep, në shfrytëzim brenda burimeve që zotëron. Ky term jo vetëm mat vlerën e mallrave apo të shërbimeve, por vlerëson cilësinë, koston, shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin, kohën dhe mundësinë për të vendosur që, të gjitha së bashku, të përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

Neni 3

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kushtet, mënyrat, kriteret dhe procedurat e dhënies së koncesioneve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Fusha e zbatimit të koncesioneve

1. Ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese për veprimtaritë ekonomike, në këta sektorë:

a) në transport (hekurudhat, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimet, transportin publik);

b) në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e të ngrohjes;

c) në prodhimin, shpërndarjen dhe administrimin e ujit, në trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen, drenazhimin, pastrimin e kanaleve e të digave;

- ç) në grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta;
- d) në telekomunikacion;
- dh) në arsim dhe sport;
- e) në shëndetësi;
- ë) në turizëm dhe kulturë;
- f) në infrastrukturën e burgjeve;
- g) në projektet e riciklimit, rehabilitimit të tokës dhe pyjeve, në parqet industriale, të strehimit, të ndërtesave qeveritare, shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së bazës së të dhënave;
- gj) në shpërndarjen e gazit natyror;
- h) në kontratat e administrimit apo në kryerjen e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të sektorëve të sipërpërmendur.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, autorizon zbatimin e koncesioneve edhe në sektorë të tjerë.

3. Në raste të veçanta, për nxitjen e investimeve në sektorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni apo për sektorë të tjerë parësorë në zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat strategjike, Këshilli i Ministrave mund t'u ofrojë investitorëve, vendas apo të huaj, koncesione me çmimin simbolik 1 euro. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, miraton listën e aseteve që do të jepen në koncesion, për efekt të zbatimit të kësaj pike.

4. Ky ligj nuk zbatohet për lëshimin e licencave, përveçse në masën që një licencë lëshohet brenda kuadrit të kontratës së koncesionit.

5. Ky ligj nuk zbatohet për prokurimet publike të shërbimeve, mallrave dhe ndërtimeve, si dhe për investimet private.

Neni 5

Autoriteti kontraktues

1. Autoriteti kontraktues çdo është ministri apo njësi e qeverisjes vendore që, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike, për të cilën jepet koncesioni.

2. Autoriteti kontraktues për koncesionet vendore është autoriteti përgjegjës i njësive të qeverisjes vendore.

3. Këshilli i Ministrave përcakton autoritetin kontraktues për çdo koncesion, pas identifikimit të koncesioneve të mundshme, sipas nenit 9 të këtij ligji.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve, për plotësimin e qëllimit dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe dokumentet standarde në fushën e koncesioneve.

Neni 6

Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare

1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave koncesionare dhe shqyrtimi administrativ i ankesave ndaj tyre bëhen nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Në ushtrim të funksioneve për koncesionet, Agjencia e Prokurimit Publik ka këto kompetenca:

a) u kërkon autoriteteve kontaktuese raportime periodike, një herë në 6 muaj, për gjendjen e koncesioneve;

b) verifikon zbatimin e procedurave koncesionare, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm;

c) propozon masa disiplinore dhe vendos gjoba në masën e përcaktuar në legjislacionin e prokurimeve, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;

ç) bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve në lidhje me procedurat e

koncesionit;

- d) vendos dhe shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, që gjatë një procedure koncesionare kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë;
- dh) i jep Këshillit të Ministrave mendim për procedurën e ndjekur për koncesionet.

Neni 7

Mbrojtja e interesave ligjorë të ofertuesve

1. Monitorimi i zbatimit të këtij ligji dhe i akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij, gjatë kryerjes së procedurave koncesionare, në mbrojtje të interesave të ligjshëm të ofertuesve, bëhet nga Avokati i Prokurimeve.

2. Në ushtrimin e funksioneve sipas këtij ligji, Avokati i Prokurimeve ka këto kompetenca:

a) shqyrton ankesat e personave të interesuar, për veprime apo mosveprime të kundërligjshme të autoritetit kontraktues;

b) fillon hetimin e procedurave administrative, kur vëren se rasti përbën shkelje të këtij ligji;

c) në përfundim të hetimit të procedurave administrative informon autoritetin kontraktues dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për rezultatet e hetimit.

3. Avokati i Prokurimeve, brenda 5 ditëve nga fillimi i hetimit, njofton personat e interesuar dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për këtë fakt.

4. Gjatë ushtrimit të funksioneve për hetimin e procedurave administrative, Avokati i Prokurimeve mund:

a) të këqyrë në vend akte dhe dokumente, që kanë lidhje me çështjen në hetim;

b) të kërkojë informacione dhe shpjegime nga administrata shtetërore apo të marrë në pyetje çdo person të lidhur me çështjen në hetim, si dhe të kërkojë ekspertizë nga të tretët;

c) të rekomandojë ndryshimin e ligjit dhe akteve të dala në zbatim të tij, kur vëren se përmbajtja e këtyre akteve krijon mundësi për shkeljen e procedurave koncesionare.

Neni 8

Njësia e Trajtimit të Koncesioneve

Njësia e Trajtimit të Koncesioneve ngrihet në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, për të nxitur dhe asistuar autoritetin kontraktues në vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve.

KREU II

IDENTIFIKIMI I KONCESIONEVE TË MUNDSHME DHE PËRZGJEDHJA E KONCESIONARIT

Neni 9

Identifikimi i koncesioneve të mundshme

1. Identifikimi i koncesioneve të mundshme bëhet nga ministritë përgjegjëse ose organet e njësive të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve.

Koncesionet e mundshme mund të identifikohen edhe nga një propozues, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji.

2. Ministritë përgjegjëse ose organet e njësive të qeverisjes vendore, me asistencën e Njësive të Trajtimit të Koncesioneve, kryejnë analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë financiare, për të gjykuar nëse duhet të zbatohet një koncesion i mundshëm. Kjo analizë bazohet në parimet e vlerës për para, në përputhshmërinë e koncesioneve të mundshme me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të sektorit, në rentabilitetin teknik dhe tregtar të koncesionit të mundshëm dhe aftësinë e tij për të tërhequr koncesionarë të mundshëm dhe financime private.

Neni 10

Fazat e përzgjedhjes

1. Koncesionarët përzgjidhen nëpërmjet një procedure parakualifikuese, që shoqërohet me një kërkesë për propozim, të parashikuar në nenet 11 deri 21 të këtij ligji. Përfshirë nga ky rregull bëjnë koncesionet e dhëna sipas pikës 2 të këtij neni dhe nenit 23 të këtij ligji.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë propozime nga të gjithë ofertuesit e mundshëm, pa një procedurë parakualifikuese, nëse e vlerëson se nuk është e nevojshme kryerja në këtë rast e procedurës parakualifikuese.

Neni 11

Procedura parakualifikuese

1. Autoriteti kontraktues përgatit ftesën për pjesëmarrje në procedurën parakualifikuese dhe dokumentet e parakualifikimit, me qëllim identifikimin e ofertuesve, që kanë kualifikimin e nevojshëm për të zbatuar koncesionin.

2. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën parakualifikuese botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në shtypin ndërkombëtar dhe vendas.

3. Ftesa për të marrë pjesë në procedurën parakualifikuese përfshin këto të dhëna:

a) një përshkrim të shkurtër të mjetit infrastrukturor;

b) tregues për elementet thelbësore të koncesionit, si shërbimet që duhet të bëhen nga koncesionari, mënyrat e financimit të koncesionit, të parashikuara nga autoriteti kontraktues (për shembull, fondet që do të përdoren, nëse janë tërësisht nga tarifatat ose pagesat e përdoruesve, apo koncesionarit mund t'i jepen fonde publike, të tilla si pagesa të drejtpërdrejta, hua ose garanci);

c) një përmbledhje të kushteve kryesore, nëse ka të tilla, të kontratës koncesionare që do të lidhet;

ç) mënyrën dhe vendin e paraqitjes së aplikimit për fazën parakualifikuese, si dhe afatin ligjor për dorëzimin, të shprehur në datën dhe orën e caktuar, duke u dhënë kohë të mjaftueshme ofertuesve për të përgatitur dhe dorëzuar aplikimet e tyre;

d) mënyrën dhe vendin e marrjes së dokumenteve të fazës parakualifikuese.

Neni 12

Dokumentet e fazës parakualifikuese

Në dokumentet e parakualifikimit përfshihen të paktën:

a) kriteret parakualifikuese, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;

b) pjesëmarrja e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;

c) çdo kërkesë për domosdoshmërinë për të krijuar një person juridik nga ofertuesi i shpallur fitues, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 13

Kriteret parakualifikuese

1. Ofertuesit e interesuar për të marrë pjesë në një procedurë përzgjedhëse duhet të plotësojnë disa kriteret objektive, të cilat autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme për një procedurë të caktuar.

Kriteret përfshijnë të paktën:

a) kualifikimet profesionale dhe teknike, burimet njerëzore, makineritë dhe asetet e tjera të nevojshme, për të kryer të gjitha fazat e projektit koncesionar, përfshirë projektimin, ndërtimin, operimin dhe, kur është e nevojshme, edhe mirëmbajtjen;

b) aftësitë e mjaftueshme për të administruar fondet financiare të projektit dhe aftësinë për të financuar projektin;

c) kapacitetet e duhura administrative dhe organizative, besueshmërinë dhe përvojën në zhvillimin e projekteve të ngjashme.

2. Ofertuesit e interesuar kualifikohen për të marrë pjesë në procedurë përzgjedhëse, kur:

a) nuk janë subjekt i një procedure falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrollueshëm apo përfundimi të veprimtarisë ose i çdo situatë tjetër që, sipas ligjeve në fuqi, sjell si pasojë procedura të të njëjtit karakter;

b) nuk janë shpallur fajtorë për paraqitjen e dokumenteve të rreme.

Neni 14

Pjesëmarrja e bashkimit të përkohshëm të shoqërive

1. Autoriteti kontraktues, para se t'i ftojë ofertuesit në fazat përzgjedhëse, duhet t'i lejojë ata të formojnë bashkime të përkohshme shoqërishe. Përveçse kur në dokumentet e parakualifikimit parashikohet ndryshe, të dhënat e kërkuara për anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për kualifikimet e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij neni, duhet t'i referohen bashkimit të përkohshëm të shoqërisë, në tërësi dhe anëtarëve të tij, në veçanti.

2. Secili anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërisë mund të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një bashkim të përkohshëm shoqërishe në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj dispozite sjell skualifikimin e bashkimit të përkohshëm të shoqërisë dhe të anëtarit të këtij bashkimi shoqërishe.

Neni 15

Vendimi për parakualifikimin

Autoriteti kontraktues bën kualifikimin e secilit ofertues, që ka paraqitur aplikimin në fazën e parakualifikimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e parakualifikimit. Autoriteti kontraktues shpall listën e ofertuesve të parakualifikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit. Të gjithë ofertuesit e parakualifikuar ftohen për të paraqitur propozimet, në përputhje me nenin 16 deri 21 të këtij ligji.

Neni 16

Procedurat për propozimet e kërkuara

1. Procedurat për propozimet e kërkuara zhvillohen me një ose dy faza.

2. Autoriteti kontraktues, kundrejt pagimit të tarifës që mund të aplikojë, u jep ofertuesve të parakualifikuar kërkesën për propozim dhe dokumentet e tjera përkatëse, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, apo dokumente të tjera, që gjykohen të nevojshme. Në rast se procedurat e parakualifikimit nuk zbatohen, kërkesa për propozim u bëhet të gjithë ofertuesve të mundshëm.

3. Pavarësisht nga sa më sipër, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën me dy faza, për të kërkuar propozime nga ofertuesit, nëse elemente të tilla të projektit të koncesionit, si specifikimet e projektit, treguesit e performancës, mënyrat e financimit apo kushtet kontraktuale nuk mund të përshkruhen në kërkesën për propozim në mënyrë aq të hollësishme dhe të saktë, që të lejojnë ofertuesit për të paraqitur propozimet e tyre përfundimtare.

4. Nëse vendoset procedura me dy faza, zbatohen këto dispozita:

a) kërkesa fillestare për propozime u kërkon ofertuesve të paraqesin, në fazën e parë të procedurës, propozimet fillestare për specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, si dhe termat kryesorë kontraktuale, të propozuar nga autoriteti kontraktues;

b) autoriteti kontraktues mund të organizojë takime dhe diskutime me çdo ofertues, për të sqaruar çështje në lidhje me kërkesën fillestare, për propozimet ose propozimet fillestare dhe dokumentet përkatëse të paraqitura nga ofertuesit. Autoriteti kontraktues pasqyron në procesverbale çdo takim apo diskutim për këtë çështje. (Procesverbali përmban çështjet e ngritura dhe sqarimet e dhëna nga autoriteti kontraktues);

c) pas shqyrtimit të propozimeve, autoriteti kontraktues mund ta rishohë dhe ta ndryshojë çdo kërkesë fillestare për propozime, duke hequr apo përshtatur çdo aspekt të specifikimeve

fillestare të projektit, treguesit e performancës, kërkesat financiare ose karakteristika të tjera të projektit, përfshirë kushtet kryesore kontraktuale dhe çdo kriter për vlerësimin, krahasimin e propozimeve dhe për caktimin e ofertuesit më të mirë, apo mund të shtojë karakteristika ose kritere të tjera. Autoriteti kontraktues shënon në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim të kërkesës për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë duhet të pasqyrohet në ftesën për të paraqitur propozimet përfundimtare;

ç) në fazën e dytë të procedurës, autoriteti kontraktues fton ofertuesit për të paraqitur propozimet përfundimtare për një paketë të vetme specifikimesh të projektit, të treguesve të performancës ose kushteve kontraktuale, në përputhje me nenet 17 deri 21 të këtij ligji.

Neni 17

Përmbajtja e kërkesës për propozim

Kërkesa për propozim, e përgatitur nga autoriteti kontraktues, përmban, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

a) të dhëna të përgjithshme, me qëllim që ofertuesit të përgatisin dhe të paraqesin propozimet e tyre;

b) specifikimet e projektit dhe treguesit e performancës, sipas rastit, përfshirë edhe kërkesat e autoritetit kontraktues për standardet e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

c) kushtet kontraktuale, të propozuara nga autoriteti kontraktues, përfshirë treguesit për kushtet e panegociueshme;

ç) kriteret që do të zbatohen për vlerësimin e propozimeve dhe, nëse do të zbatohen, edhe kufijtë minimalë për vlerësimin e propozimeve, peshën përkatëse të çdo kriteri dhe mënyrën, sipas së cilës kriteret dhe kufiri minimal duhet të zbatohen në vlerësimin dhe skualifikimin e propozimeve;

d) kërkesat për garancinë e ofertës.

Neni 18

Sqarimet dhe modifikimet

1. Autoriteti kontraktues, me nismën e vet apo si rezultat i një kërkesë për sqarim nga një ofertues, mund të rishohë dhe, sipas rastit, të ndryshojë çdo element të kërkesës për propozim, sipas nenit 17 të këtij ligji.

Çdo ndryshim u njoftohet menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë tërhequr dokumentet e garës. Kur autoriteti kontraktues e vlerëson të nevojshme të ndryshojë dokumentet dhe kjo bëhet brenda një periudhe kohe më pak se 1/3 e numrit të ditëve të përcaktuara për përgatitjen e ofertave, duhet ta shtyjë afatin e fundit të paraqitjes së ofertave për të njëjtën periudhë kohe.

2. Autoriteti kontraktues, në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shënon në regjistrin e koncesioneve arsyet për çdo rishikim në kërkesën për propozim. Çdo shfuqizim, ndryshim apo shtesë u komunikohet ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozim.

Neni 19

Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike përfshijnë të paktën:

a) qëndrueshmërinë teknike;

b) përputhjen me standardet e mjedisit;

c) efikasitetin në veprim;

ç) cilësinë e shërbimeve dhe të masave, për të siguruar vazhdimësinë e tyre;

d) potencialin e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, që ofrohet nga propozimet.

2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe tregtare, sipas rastit, përfshijnë të paktën:

a) vlerën aktuale të tarifave dhe të çmimeve për njësi të propozuara dhe pagesa të tjera gjatë periudhës koncesionare;

b) vlerën aktuale të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara, të bëra nga autoriteti kontraktues, nëse ka;

c) shpenzimet për projektin dhe veprimtaritë e ndërtimit, shpenzimet për operimin dhe mirëmbajtjen vjetore, vlerën e tashme të investimeve, të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes;

ç) masën e mbështetjes financiare, nëse ka, që pritet të realizohet nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Shqipërisë;

d) qëndrueshmërinë dhe rentabilitetin e financimeve të propozuara.

3. Këshilli i Ministrave, për efekt të zbatimit të pikës 3 të nenit 4 të këtij ligji, përcakton edhe kritere të tjera, që do të merren parasysh në vlerësimin e ofertave. Këto kritere bazohen në rëndësinë sektoriale të zhvillimit të ekonomisë, vlerën e investimit, nivelin e punësimit, përparësinë për zhvillimin e zonave të veçanta të vendit, tregues të tjerë specifikë të sektorëve, si dhe çmimin apo tarifën e propozuar. Këshilli i Ministrave, në këtë rast, përcakton dhe peshën që do të ketë çdo kriter në vlerësimin e ofertës.

Neni 20

Krahasimi dhe vlerësimi

1. Autoriteti kontraktues krahason dhe vlerëson çdo propozim, në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative, që i jepet çdo kriteri në procesin e vlerësimit, të parashikuar në kërkesën për propozim.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues mund të vendosë kufij minimalë për cilësinë, aspektet teknike, financiare dhe tregtare. Propozimet, që nuk arrijnë kufijtë minimalë, vlerësohen të papërshtatshëm dhe skualifikohen.

Neni 21

Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtare

1. Autoriteti kontraktues rendit të gjitha propozimet e pranueshme, në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe njofton ofertuesit për këtë. Pas njoftimit, të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre, në përputhje me dispozitat e kreut III të këtij ligji. Me mbarimin e afatit për paraqitjen e ankesave, autoriteti kontraktues fton ofertuesin, që ka marrë vlerësimin më të mirë, për negociime përfundimtare.

2. Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.

3. Nëse për autoritetin kontraktues, brenda një afati të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, bëhet e qartë se negociimet me ofertuesin e ftuar nuk do të përfundojnë me një kontratë koncesionare, ai i ndërpret negociimet me këtë ofertues dhe fton ofertuesit e tjerë, sipas renditjes, derisa të arrihet lidhja e kontratës së koncesionit, ose i refuzon të gjitha propozimet e mbetura. Autoriteti kontraktues nuk mund të rifillojë negociime me një ofertues, me të cilin negociimet janë ndërprerë, në përputhje me këtë pikë.

4. Pas përfundimit të negociimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit të kontratës së koncesionit, ajo ia paraqet Këshillit të Ministrave për miratim.

5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit brenda 30 ditëve pas miratimit të saj, në përputhje me përcaktimin e pikës 4 të këtij neni.

Neni 22

Negocimi i kontratave koncesionare pa procedura konkurruese

1. Autoriteti kontraktues mund të bëjë negociimin e kontratave koncesionare pa procedura konkurruese vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave, nëse:

a) projekti ndikon në cenimin e sigurisë kombëtare. Rastet e cenimit të sigurisë kombëtare, si rezultat i zbatimit të procedurave konkurruese, miratohen me vendim të Këshillit të Sigurisë Kombëtare;

b) kontrata koncesionare është zgjidhur për shkak të një shkeljeje serioze nga ana e koncesionarit dhe kur procedura konkurruese nuk është e mundur të realizohet, për shkak të nevojës urgjente për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë.

2. Kohëzgjatja e një kontrate koncesioni, të lidhur sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, nuk duhet të kalojë 12 muaj.

3. Asnjë kontratë koncesionare nuk mund të realizohet sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, përveçse kur autoriteti kontraktues ka filluar një procedurë konkurruese përzgjedhëse për koncesionarin, në përputhje me kushtet e kontratës, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, apo kur ka vendosur të mos e japë koncesionin, me kalimin e afatit të përcaktuar në kushtet e kontratës.

4. Nëse një kontratë koncesioni negociohet në përputhje me këtë nen, pa përdorur procedurën konkurruese, autoriteti kontraktues duhet të caktojë kritere të arsyeshme vlerësimi për kërkesat e projektit, në bazë të të cilave do të vlerësohen dhe do të renditen propozimet.

5. Autoriteti kontraktues boton në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e koncesionarit dhe kushtet thelbësore të kontratës së koncesionit brenda 30 ditëve nga data e miratimit të kontratës së koncesionit nga Këshilli i Ministrave, përveç rasteve të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 23

Propozimet e pakërkuara

1. Autoriteti kontraktues është i autorizuar të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin ka filluar ose është shpallur procedura e përzgjedhjes.

2. Procedurat për përcaktimin e pranueshmërisë së propozimeve të pakërkuara janë:

a) brenda 90 ditëve pas marrjes dhe shqyrtimit fillestar të propozimit të pakërkuar, autoriteti kontraktues përcakton nëse projekti koncesionar paraqet interes publik dhe për këtë vë në dijeni propozuesin;

b) kur projekti koncesionar paraqet interes publik, autoriteti kontraktues fton propozuesin të paraqesë të dhëna të tjera të nevojshme për projektin e propozuar, për të bërë vlerësimin për kualifikimet e propozuesit dhe fizibilitetin teknik dhe financiar të projektit;

c) brenda 120 ditëve nga ftesa e autoritetit kontraktues, propozuesi duhet të paraqesë një studim fizibiliteti teknik dhe financiar (duke përfshirë, por pa u limituar në të, një model financiar dhe një plan për financimin e projektit), një studim për ndikimin në mjedis dhe të dhëna të mjaftueshme për konceptin ose teknologjinë e parashikuar në propozim;

ç) gjatë shqyrtimit të një propozimi të pakërkuar, autoriteti kontraktues respekton pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive të parashikuara, që rrjedhin apo që përmenden në propozim. Informacionin e dhënë nga/ose në emër të propozuesit për propozimin e pakërkuar, autoriteti kontraktues nuk e përdor pa pëlqimin paraprak të propozuesit, për një periudhë prej 12 muajsh nga data e marrjes së këtij informacioni.

3. Fillimi i një procedure përzgjedhëse bëhet si më poshtë:

a) autoriteti kontraktues, brenda 6 muajve nga marrja e dokumentacionit, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, vendos për pranimin ose refuzimin e projektit të mundshëm koncesionar, që rrjedh nga propozimi i pakërkuar. Nëse propozimi i pakërkuar pranohet nga autoriteti kontraktues, ai fillon një procedurë përzgjedhëse konkurruese në përputhje me nenet 11

deri 21 të këtij ligji, ndërsa kur propozimi refuzohet dhe palët nuk bien dakord ndryshe, autoriteti kontraktues i kthen propozuesit dokumentet origjinale dhe fotokopjet e dokumenteve të paraqitura;

b) propozuesi ftohet të marrë pjesë në procedurën përzgjedhëse konkurruese, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni dhe, me vendim të Këshillit të Ministrave, atij i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës përzgjedhëse konkurruese

deri në një maksimum 10 për qind të pikëve. Identiteti i propozuesit, ekzistenca dhe shuma e bonusit tregohen në dokumentet e procedurës përzgjedhëse konkurruese.

Neni 24
Konfidencialiteti

Autoriteti kontraktues ruan konfidencialitetin e të gjitha të dhënave teknike, ekonomike, financiare etj. të propozimeve të bëra nga ofertuesit. Nëse nuk parashikohet me ligj, me vendim gjykate apo në kërkesën për propozim, palët në bisedime nuk i deklarojnë personave të tjerë informacione teknike, të dhëna për çmimin dhe elemente për diskutimet, komunikimet dhe bisedimet, në përputhje me dispozitat e mësipërme, pa pëlqimin e palës tjetër.

KREU III
PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV

Neni 25
Procedura e ankimit

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga autoriteti kontraktues është në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji apo të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për procedurat e koncesionit.

2. Ankesa paraqitet tek Agjencia e Prokurimit Publik brenda 5 ditëve kalendarike nga data e botimit të njoftimit të kandidatëve të parakualifikuar apo e njoftimit të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.

3. Me marrjen e ankesës, Agjencia e Prokurimit Publik njofton brenda 5 ditëve autoritetin kontraktues në lidhje me pezullimin e procedurave koncesionare dhe fillimin e procedurave të hetimit administrativ.

4. Agjencia e Prokurimit Publik nuk pezullon procedurën koncesionare në rastet kur:

a) nga shqyrtimi paraprak rezulton se ankesa nuk është e argumentuar juridikisht;
b) pezullimi vjen në kundërshtim me interesin publik apo dëmton autoritetin kontraktues ose ofertuesit e tjerë.

5. Gjatë shqyrtimit të ankesës, deri përpara lidhjes së kontratës, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të shfuqizojë pjesërisht apo plotësisht vendimet ose aktet e autoritetit kontraktues;
b) ta udhëzojë autoritetin kontraktues për korrigjimin e shkeljeve përpara vazhdimin të procedurave koncesionare.

6. Agjencia e Prokurimit Publik, gjatë procedurave të hetimit administrativ, ka të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

7. Ankesa në Agjencinë e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Agjencia e Prokurimit Publik e shqyrton ankesën, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe Kodin e Procedurave Administrative.

8. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon hetimin administrativ dhe njofton autoritetin kontraktues dhe ankuesin për vendimin.

9. Vendimi i Agjencisë së Prokurimit Publik është akti administrativ përfundimtar.

Neni 26
Ankimi në gjykatë

Kundër vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë që, brenda 30

ditëve nga marrja dijëni, të bëjë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (seksioni administrativ).

Gjykata kryen shqyrtimin gjyqësor, sipas procedurave dhe brenda afateve të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, kreu II, “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon vazhdimin e procedurave të koncesionit.

KREU IV KONTRATA KONCESIONARE

Neni 27 **Përmbajtja**

Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si:

a) natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari;

b) kohëzgjatja e kontratës së koncesionit që përshtatet me specifikën e koncesionit përkatës, por që nuk i kalon 35 vjet dhe kushtet, nëse ka, për zgjatjen e saj;

c) ndihma që mund t’i japë autoriteti kontraktues dhe njësia e trajtimit të koncesioneve koncesionarit për marrjen e licencave dhe të lejeve të nevojshme për koncesionin;

ç) çdo kërkesë për themelimin dhe kapitalin themeltar të një personi juridik, që duhet të krijohet nga ofertuesi i shpallur fitues, në bazë të ligjeve në fuqi, si dhe ndalimin për transferimin e aksioneve apo të pjesëve të kapitalit të kësaj shoqërie, pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues;

d) pronësia e asetëve të projektit të koncesionit dhe detyrimet e palëve, sipas rastit, për vënien në dispozicion të vendit të projektit të koncesionit dhe çdo lehtësi tjetër të mundshme;

dh) shpërblimi i koncesionarit, pavarësisht nëse përbëhet nga tarifa apo pagesa për përdorimin e mjetit të infrastrukturës ose realizimit të shërbimeve, metodat dhe formulat për caktimin ose rregullimin e këtyre tarifave apo pagesave, si dhe, nëse zbatohen, pagesat që mund të bëhen nga autoriteti kontraktues ose një autoritet tjetër publik, si dhe nëse ka detyrimin për pagesa që koncesionari duhet t’i bëjë autoritetit kontraktues;

e) procedurat për rishikimin dhe miratimin e projekteve inxhinierike, të planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga autoriteti kontraktues, si dhe procedurat për testimin dhe kontrollin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e mjetit të infrastrukturës, rregullat dhe standardet, në bazë të të cilave janë projektuar projektet koncesionare, që duhet të jenë në përputhje me praktikën më të mirë, me synim zhvillimin e tregut nëpërmjet ndarjes së riskut;

ë) shtrirja e detyrimeve të koncesionarit, sipas rastit, për të siguruar ndryshimin e shërbimit, për të përmbushur kërkesat e kohës, vazhdimësinë e tij dhe dhënien, në kushte kryesisht të njëjta për të gjithë përdoruesit, mekanizmat për të trajtuar kostot e mundshme për to;

f) e drejta e autoritetit kontraktues ose e një autoriteti tjetër publik për të monitoruar punët që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari, kushtet dhe masën, në të cilën autoriteti kontraktues mund të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit. E drejta e autoritetit kontraktues për të marrë masa të tjera të arsyeshme, për të siguruar që mjeteve infrastrukturor të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuale, si dhe e drejta për të monitoruar mekanizmat dhe trajtimin e shpenzimeve të mundshme për to;

g) detyrimet e koncesionarit për t’i dhënë autoritetit kontraktues apo një autoriteti tjetër publik, sipas rastit, raporte dhe informacion tjetër për veprimtarinë;

gj) çdo kufizim ose kusht të zbatueshëm për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të koncesionarit, sipas kontratës së koncesionit;

h) çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të koncesionarit;

i) përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera në

rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës së koncesionit);

j) detyrimet e mundshme, nëse ka, të autoriteteve publike përkatëse ose të autoritetit kontraktues;

k) rrethanat, në të cilat autoriteti kontraktues ka të drejtën të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e mjetit të infrastrukturës, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga koncesionari, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës;

l) çdo të drejtë të autoritetit kontraktues për të rishikuar dhe miratuar kontratat kryesore, që duhet të lidhen nga koncesionari, veçanërisht me aksionerët e koncesionarit ose persona të tjerë juridikë, ku koncesionari është pjesëmarrës apo anasjelltas;

ll) garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e sigurimeve që duhet të ndiqen nga koncesionari për zbatimin e koncesionit;

m) procedurat e rregullimit të shkeljes së kontratës, të bërë nga njëra prej palëve;

n) kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e kontratës; të drejtat dhe detyrimet e palëve, me kalimin e afatit apo përfundimin e kontratës (duke përfshirë mekanizmin e transferimit të sendeve pasurore, të teknologjisë, kompensimit, shërbimin e trajnimit dhe të mbështetjes që duhet të jepet nga koncesionari);

nj) ligji i zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit;

o) të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacionin konfidencial.

Neni 28

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

1. Autoriteti kontraktues, nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratën e koncesionit, mund ta zgjidhë kontratën kur:

a) ka arsye të mendojë se koncesionari nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet, për shkak të paaftësisë paguese, shkeljeve serioze apo të rasteve të tjera që pengojnë apo nuk bëjnë të mundur vazhdimin e kontratës së koncesionit;

b) koncesionari dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës së koncesionit.

2. Secila palë, nëse nuk është parashikuar ndryshe në kontratën e koncesionit, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

KREU V
FINANCIMI

Neni 29

Masat financiare

1. Koncesionari ka të drejtë të vendosë, të marrë ose të mbledhë tarifa apo të ardhura të tjera për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij, në përputhje me kontratën e koncesionit, e cila parashikon mënyrat dhe formulat e caktimit e të ndryshimit të këtyre tarifave ose pagesave.

2. Autoriteti kontraktues ka të drejtë t'i bëjë koncesionarit pagesa të drejtpërdrejta, si zëvendësim apo si shtesë e tarifave ose pagesave për përdorimin e aseteve ose të shërbimeve të realizuara prej tij.

KREU VI ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 30 Ligji i zbatueshëm

1. Kontrata e koncesionit u nënshtrohet ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Koncesionari, aksionerët e tij dhe ortakët e tjerë të veprimtarisë së tij ekonomike janë të lirë të zgjedhin ligjin që rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Neni 31 Mosmarrëveshjet ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit zgjidhet me mekanizmat e përcaktuar në kontratën e koncesionit, për të cilët palët kanë rënë dakord, përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.
2. Koncesionari, aksionerët e tij dhe ortakët e tjerë të tij janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e përshtatshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32 Shfuqizime

Ligji nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 33 Periudha tranzitore deri në krijimin e Njesisë së Trajtimit të Koncesioneve

Deri në krijimin e Njesisë së Trajtimit të Koncesioneve, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe bërjes së saj plotësisht operacionale, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë ministria përgjegjëse për ekonominë.

Neni 34 Ligjet ekzistuese për fusha specifike

1. Në rast mospërputhjeje me ligjet ekzistuese, ky ligj mbizotëron mbi të gjitha ligjet e tjera

për koncesionet.

2. Të gjitha ligjet për sektorë të veçantë duhet t'i rregullojnë koncesionet në përputhje me këtë ligj.

Neni 35

Kontratat e koncesionit që janë nënshkruar

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit, të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kontratat nuk mund të ripërsëriten ose të shtyhen, veçse në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5179, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9665, datë 18.12.2006

PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj synon të rregullojë emetimin dhe menaxhimin e huamarrjes shtetërore, të borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë.

Neni 2

Kuptimi i huasë shtetërore

Huamarrja shtetërore është një marrëveshje e shkruar, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti shqiptar siguron fonde nga një apo më shumë huadhënës dhe dispozita për shlyerjen e huave.

Neni 3

Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë

Garancia shtetërore e huasë është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për

detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.

Garancia është detyrimi për pagesën e detyrimit financiar të një personi juridik, në rast se pala, që mban përgjegjësinë kryesore për pagesën e detyrimit financiar, nuk ka arritur ta paguajë atë në kohën e duhur.

Garancia shtetërore e huasë është shuma e përgjithshme e huave, për të cilat Ministri i Financave ka nënshkruar marrëveshje garancie në emër të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Kuptimi i borxhit shtetëror

Borxh shtetëror është shuma e përgjithshme e borxhit të shtetit, e emetuar në monedhën kombëtare dhe/ose në një monedhë zyrtare të ndryshme nga monedha kombëtare, i cili nuk përfshin detyrimet financiare të bashkive/komunave apo të ndonjë autoriteti tjetër të pushtetit vendor. Borxhi shtetëror përfshin edhe borxhet e Republikës së Shqipërisë, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për efekt të përllogaritjes së borxhit shtetëror, në rastin kur një detyrim i papaguar është emetuar në një monedhë të ndryshme nga monedha kombëtare, ai vlerësohet në monedhën kombëtare, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në çastin e vlerësimit.

Neni 5

Titujt e shtetit

Titujt e shtetit janë instrumentet e borxhit shtetëror, të emetuara me interes, me bazë zbritjeje apo të kombinuara, me interes dhe bazë zbritjeje, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave.

Neni 6

Menaxhimi i borxhit dhe raportimi i tij

Menaxhimi i borxhit ka si objekt kryesor sigurimin e fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.

Ministri i Financave përgatit strategjinë afatmesme për vlerësimin e portofolit të borxhit dhe të ecurisë së tij. Kjo strategji rishikohet dhe paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, së bashku me parashikimet e buxhetit afatmesëm.

Ministri i Financave përgatit raportin vjetor për gjendjen e borxhit shtetëror, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe paraqitet në Kuvend, si pjesë përbërëse e raportit të realizimit të buxhetit të konsoliduar për vitin përkatës.

Neni 7

Qëllimi i marrjes së borxhit

Ministri i Financave, në emër të Këshillit të Ministrave, merr hua:

- a) për të financuar deficitin buxhetor të shtetit;
- b) për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditetit;
- c) për të rifinancuar borxhin shtetëror, të nënshkruar më parë;
- ç) për të paguar garancitë shtetërore;
- d) për të paguar koston e emetimit të borxhit shtetëror;
- dh) për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjenca të tjera.

Neni 8

Monedha për nënshkrimin, emetimin dhe pagesën e borxhit shtetëror

Borxhi shtetëror nënshkruhet, emetohet dhe paguhet në monedhë kombëtare dhe/ose në monedhë të huaj.

Neni 9

Kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave

Kufizimet për shumën e borxhit shtetëror dhe për shumën e garancive shtetërore të huave përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit. Kufizimet e parashikuara të borxhit i referohen, në radhë të parë, shumës së borxhit dhe shumës së garancive të marra rishtazi dhe, në radhë të dytë, shumës së përgjithshme të borxhit shtetëror dhe të garancive të papaguara në fund të vitit. Kufizimi vjetor jepet për të mbuluar humbjet e bankës qendrore nga rivlerësimi i valutave.

Ndryshimet në kursin e këmbimit valutor, pas emetimit të borxhit shtetëror apo pas emetimit të garancisë shtetërore të huasë, që shkaktojnë kapërcimin e kufizimeve të parashikuara ndaj shumës së papaguar të borxhit shtetëror apo garancisë shtetërore të huasë, nuk përbëjnë shkelje të ligjit.

Borxhi shtetëror, i emetuar për të përballuar koston e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe emergjenca të tjera, nuk i nënshtrohet kufizimit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni. Çdo borxh shtetëror, i emetuar për këtë qëllim, do të përfshihet në përllogaritjen e borxhit shtetëror të papaguar, menjëherë pas emetimit të tij.

KREU II

BORXHI I KONTRAKTUAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 10

Autoriteti i borxhit shtetëror

Ministri i Financave emeton titujt e shtetit, të cilat mund të jenë afatgjata ose afatshkurtra dhe hyn në negociata për marrëveshjet e huave shtetërore.

Neni 11

Statusi i parave të marra borxh

Fondet e mbledhura nëpërmjet huamarrjes klasifikohen si të hyra për qëllimet e financimit të deficitit buxhetor.

Neni 12

Dhënia e garancisë shtetërore të huasë

Garancia shtetërore e huasë u jepet institucioneve huadhënëse me miratimin e Ministrisë të Financave.

Neni 13

Natyra e detyrimit të borxhit shtetëror

Borxhi shtetëror përbën një detyrim absolut dhe pa kushte të shtetit. Shteti angazhohet dhe garanton plotësisht, në përputhje me kushtet e përcaktuara për titujt e shtetit dhe në marrëveshjet e huasë, pagimin në kohë të interesave dhe shlyerjen e principalit.

Neni 14

Financimi i përhershëm

Në ligjin vjetor të buxhetit parashikohen fonde të mjaftueshme për pagesën e interesit dhe shlyerjen e principalit, për llogari të borxhit shtetëror. Ministri i Financave, pasi përcakton se

pagesa është e detyrueshme, autorizon derdhjen e menjëhershme të saj.

Neni 15

Përparësia e borxhit shtetëror

Të gjitha detyrimet, që përbëjnë borxh shtetëror, trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga koha kur janë krijuar dhe pavarësisht nëse janë në formën e titujve të shtetit apo të marrëveshjeve të huasë. Pagesa e principalit apo e interesit të borxhit shtetëror trajtohet me përparësi, në krahasim me pretendimet ndaj llogarisë së depozitës së përgjithshme të Këshillit të Ministrave. Këto pagesa janë parësore ndaj çdo pretendimi tjetër për pagesë nga depozita e lartpërmendur.

KREU III

TITUJT E SHTETIT

Neni 16

Autoriteti i emetimit

Ministri i Financave emeton titujt e shtetit, në formën e regjistrimit në llogari apo në formë fizike. Ministri i Financave autorizon krijimin e sistemit të regjistrimit kompjuterik për titujt e emetuar, në formën e regjistrimit në llogari, si dhe administrimin e këtij sistemi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi.

Neni 17

Gjendja e titujve të emetuar në llogari

Sistemi i regjistrimit në llogari është sistemi i kompjuterizuar, i autorizuar nga Ministri i Financave për regjistrimin, për llogari të zotëruesve, të nxjerrjeve, gjendjes së llogarisë, shërbimit dhe pagesës së titujve të shtetit dhe mbahet në formë të pacertifikuar apo jofizike.

Titujt të emetuar në formë regjistrimi në llogari janë titujt e emetuar dhe të mbajtur në mënyrë të kompjuterizuar apo regjistrimi kontabël në sistemin e autorizuar të sistemit të regjistrimit në llogari.

Titujt e shtetit, të emetuar në formën e regjistrimit në llogari, janë detyrime të shtetit dhe, si të tilla, nuk ndryshojnë nga titujt e shtetit, të emetuar në formë fizike, megjithëse emetimi, mbajtja e llogarisë dhe transaksionet e tyre, përfshirë edhe pagesa në maturim, realizohen në mënyrë elektronike. Pronari i regjistruar i titujve të shtetit, të emetuar në llogari, ka të drejta të plota mbi këta tituj.

Neni 18

Gjendja e titujve të shtetit, të emetuar në formë fizike

Certifikata apo titulli i certifikuar është titulli i autorizuar dhe i emetuar në formë të pandryshueshme fizike, që ka të shënuar emrin e zotëruesit në faqen e përparme të saj, apo përcaktime të tjera, në bazë të të cilave ajo është e pagueshme për zotëruesin.

Titujt e shtetit, të emetuar në certifikatë apo në formë fizike, janë detyrime të shtetit, të cilat identifikohen nëpërmjet serive të emetimit, numrit përkatës serial dhe vlerës nominale të tyre. Titujt e shtetit mund të emetohen në formë fizike, për të evidentuar, në mënyrë kolektive, një numër titujsh, që mbajnë të njëjtin përshkrim, por që emetohen në formën e regjistrimit në llogari. Kur titujt e emetuar më parë, në formë fizike, janë konvertuar në llogari, me kërkesë të pronarit ato nuk mund të rikonvertohen në formë fizike.

Neni 19

Tregtueshmëria

Titujt e shtetit janë të tregtueshëm ose të patregtueshëm, në varësi të kushteve të emetimit.

Neni 20

E drejta për caktimin e kushteve

1. Ministri i Financave është i autorizuar të emetojë tituj të shtetit nëpërmjet këtyre formave:
 - a) me ankand, duke ushtruar, kur është e nevojshme, të drejtën për të hedhur poshtë njërën apo të gjitha kërkesat;
 - b) në bazë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe.
2. Kushtet e emetimit të këtyre titujve shtetërorë janë:
 - a) me zbritje apo me normë fikse dhe/ose të ndryshueshme;
 - b) me emërtime të caktuara;
 - c) me emetim dhe datë maturimi të caktuar;
 - ç) me kufizim në sasinë e hedhur për shitje;
 - d) me datë të caktuar për pagimin e interesit;
 - dh) me thirrje, kur ekziston e drejta për të thirrur titujt e shtetit përpara datës së lajmëruar të maturimit.

Neni 21

Derivativët

1. Derivativët janë instrumente të derivuara nga kushtet e borxhit shtetëror të papaguar, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe shkëmbime të normës së interesit apo shkëmbime të monedhës.
2. Ministri i Financave, në përputhje me strategjinë e menaxhimit të borxhit, është i autorizuar të emetojë derivativë.

Neni 22

Blerja e borxhit

Ministri i Financave, në përputhje me portofolin e borxhit dhe të situatës buxhetore, është i autorizuar të bëjë blerjen e borxhit apo të hyjë në transaksione të tjera në tregun sekondar.

Neni 23

Dispozitat e zbatueshme

Emetimi i titujve të shtetit bëhet në përputhje me ligjin në fuqi, që rregullon emetimin, transaksionet me titujt, si dhe subjektet e përfshira në këto transaksione.

Neni 24

Kufizime për pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit

Pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit nuk mund të bashkëpunojnë me një apo më shumë pjesëmarrës të tjerë, me qëllim që ta ndikojnë këtë treg, për sa u përket interesit, çmimit, sasisë së titujve të shtetit, që kanë të njëjtin përshkrim, si për ato të blera në ankand, ashtu edhe për ato të blera në tregun sekondar, si përbërje e portofolit, që mban secili nga pjesëmarrësit e tregut dhe të strategjisë së investimit të secilit pjesëmarrës në treg.

Pjesëmarrësit në tregun e titujve të shtetit nuk mund të marrin pjesë në çfarëdolloj transaksioni, praktike apo veprimi, që përbën shkelje apo mashtrim ndaj pjesëmarrësve të tjerë në treg. Për këtë zbatohen sanksionet, administrative dhe penale, të parashikuara në ligjin, që rregullon emetimin, transaksionet me titujt dhe subjektet e përfshira në këto transaksione.

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE PËR BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË

Neni 25

Këshillimet për borxhin

Ministri i Financave kërkon mendimin e Bankës së Shqipërisë për:

a) gjendjen e ndikimin e borxhit shtetëror mbi rezervat në monedhë të huaj, si dhe bilancin e pagesave;

b) shkëmbimin në kohën e duhur të informacionit për financimin e borxhit shtetëror të mëparshëm, atij aktual dhe të parashikuar;

c) shkëmbimin e informacionit për kurset e këmbimit valutor dhe prirjet e tij, për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, për politikën fiskale të Ministrisë së Financave, në mënyrë që secila palë të jetë në gjendje të marrë parasysh, në mënyrë të përshtatshme, pikëpamjet e palës tjetër në procesin e planifikimit dhe të vendimmarrjes.

Neni 26

Procedurat e negociimit, miratimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për huatë shtetërore dhe garancitë shtetërore të huasë

Ministria e Financave mban kontakte zyrtare të drejtpërdrejta me kreditorët për sigurimin e financimeve nëpërmjet kredive. Në rastet kur për financimin e një projekti, investim publik, merret kredi nga banka private, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, kur marrëveshja ndërkombëtare nuk parashikon rregullim tjetër.

Pas marrjes së konfirmimit nga kreditorët për mundësinë e plotësimit të kërkesave për financim, Ministri i Financave i kërkon Kryeministrit plotfuqinë për zhvillimin e bisedimeve me kreditorin. Plotfuqia nënshkruhet edhe nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Pas negociimit, ministri i linjës dhe Ministri i Financave, me propozim të përbashkët, paraqesin për miratim, në parim, në Këshillin e Ministrave, marrëveshjet e kredisë, si dhe garancitë e negociuara.

Marrëveshja e huasë miratohet nga Këshilli i Ministrave, në emër të Republikës së Shqipërisë.

Kryeministri, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon plotfuqinë për nënshkrimin e marrëveshjeve të kredive ose garancive nga Ministri i Financave. Plotfuqia nënshkruhet edhe nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë dhe të garancisë, Ministria e Financave depoziton në Ministrinë e Punëve të Jashtme kopjen origjinale të këtyre marrëveshjeve, për ndjekjen e procedurave të ratifikimit, të përcaktuara në ligjin nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Për marrëveshjet e kredisë ose të garancisë, që lidhen në emër të shtetit shqiptar, pas ratifikimit të tyre nga Kuvendi, Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të marrëveshjes dhe se marrëveshjet janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Këshilli i Ministrave miraton kompetencat dhe procedurat për nënshkrimin, lëvrimin dhe raportimin e huave, të kredive dhe garancive, në emër të shtetit shqiptar.

Neni 27

Efektet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të traktateve apo konventave

Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë, të kontraktuara nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, traktateve apo konventave, përdoren, shërbejnë dhe shlyhen në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këto dokumente.

Neni 28
Përparësia e së drejtës ndërkombëtare

Në rast se kushtet dhe afatet e marrëveshjeve, të traktateve apo konventave ndërkombëtare për përdorimin, shërbimin dhe shlyerjen e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huasë bien në kundërshtim me cilëndo dispozitë të këtij ligji apo me dispozita të ligjeve të tjera, parashikimet, kushtet dhe afatet e marrëveshjeve, të traktateve apo konventave ndërkombëtare zbatohen me përparësi.

Neni 29
Depozitimi i fondeve të huave shtetërore

Të gjitha fondet e përfutuara nga huatë shtetërore depozitohen në Bankën e Shqipërisë, në një nënlligori të veçantë të Ministrisë së Financave. Këto fonde përdoren sipas dispozitave ligjore në fuqi apo sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjes, në bazë të së cilës janë marrë në dorëzim.

Neni 30
Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror, mbi të cilat zbatohen kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare

Ministri i Financave, kur e lejojnë kushtet e marrëveshjeve, nga të cilat rrjedh një borxh shtetëror, autorizohet të japë hua nga fondet që përbëjnë të ardhura të borxhit shtetëror, për huamarrësit, përfshirë këtu edhe institucionet financiare dhe pushtetin vendor, me veprimtari kryesore brenda Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që këta të fundit të mundësojnë financimin e projekteve të investimit, importit apo të veprimtarive të tjera.

Procedurat për huazimin e fondeve dokumentohen me shkrim, nëpërmjet marrëveshjeve të nënhuasë, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe huamarrësit.

Është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, sipas paragrafit të parë të këtij neni, që t'i kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave dhe të paraqesin raporte për gjendjen e huasë dhe përdorimin e saj, sipas kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

Huamarrësi, që ka marrë fonde sipas paragrafit të parë të këtij neni, detyrohet që, për çdo humbje financiare që ndodh në transaksionet e nënhuasë, të vërë në dijeni Ministrinë e Financave me të dhëna të qarta dhe bindëse se ka ushtruar mbikëqyrje të përshtatshme për të mënjanuar humbjen. Ministri është i autorizuar të ndërmarrë çdo hap tjetër lehtësues ligjor për mbledhjen e të ardhurave.

Ministri i Financave, sipas gjykimit të tij, mund t'u kërkojë huamarrësve, të cilëve u janë dhënë fonde në përdorim, sipas paragrafit të parë të këtij neni, të paguajnë principalin e huasë, interesin, komisionet dhe të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga marrëveshja e nënhuasë, në monedhën e vendit apo në monedha të tjera, të ndryshme nga monedha kombëtare.

KREU V
AGJENTI FISKAL I SHTETIT

Neni 31
Emërimi i agentit fiskal

Ministri i Financave emëron agjentin fiskal të shtetit. Kushtet dhe kriteret për emërimin e agjentit fiskal përcaktohen në aktet nënligjore. Marrëdhëniet me agjentin fiskal përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta me Ministrinë e Financave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në të.

Agjenti fiskal, në përputhje me funksionet, ka këto kompetenca:

a) zhvillon ankandet e titujve të shtetit dhe, lidhur me këto të fundit, publikon njoftimet mbi sasinë e ofruar nga Ministria e Financave, formularët dhe udhëzimet për të interesuarit, si dhe informacion për rezultatet e ankandit;

b) krijon dhe mban një sistem regjistrimi në llogari për titujt e shtetit, i cili regjistron emetimin, transfertat, transaksionet, si dhe pagesën e titujve të emetuar në formën e regjistrimit në llogari.

Ky sistem duhet të pasqyrojë me saktësi pronësinë dhe gjendjen e titujve, në përputhje me marrëveshjet e lidhura me agjentin fiskal dhe dispozitat ligjore;

c) mban stokun e titujve të shtetit dhe administron emetimin e tyre, në rast se këto tituj do të emetohen në formë fizike, duke mbajtur të dhëna të sakta për këtë emetim;

ç) mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke përmirësuar mundësitë e përdorimit të sistemit të regjistrimit në llogari, nëpërmjet institucioneve financiare, që mbajnë llogaritë e pagesave në bankë;

d) administron dhe bashkërendon sistemin e regjistrimit në llogari me sistemin e pagesave, që bankat kanë për institucionet, në mënyrë që t'u mundësojë personave që tregtojnë tituj të shtetit krahasimin e dërgesave me pagesat brenda këtij sistemi;

dh) mban, në emër të Ministrisë së Financave, llogarinë e unifikuar të thesarit, në mënyrë që paratë e depozituara ose të tërhequra, për titujt e shtetit, të emetuar ose të paguar për interesin dhe principalin e tyre, të realizohen në kohën e duhur, në çastin e emetimit dhe të maturimit të tyre;

e) ofron shërbime të tjera, përfshirë vlerësimin, sipas kërkesës, të gjendjes financiare të institucioneve huadhënëse, që marrin pjesë në programet e garancive shtetërore të huave apo dhe në çështje të tjera, të zgjedhjes së pjesëmarrësve në tregun primar të titujve të shtetit.

KREU VI RREGULLIMET NË LLOGARI

Neni 32 Rregullimet në llogari

Ministria e Financave bën rregullimet në llogari për humbjen, vjedhjen, shkatërrimin apo dëmtimin e titujve të shtetit në qarkullim, të emetuar në formë fizike, me kusht që titujt të jenë të identifikuar me përshkrim, numër serie dhe që ministrisë t'i dorëzohet një kërkesë e plotë për rregullim nga pala e interesuar, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Neni 33 Pagesa e dyfishtë

Kur zbatimi i rregullimit në llogari, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, është i nevojshëm, por shkakton realizimin e një pagese të dyfishtë apo të dytë për titujt në fjalë, Ministria e Financave mund të kompensojë humbjet e shkaktuara, duke i trajtuar si shpenzime të ndryshme, të realizuara në procesin e administrimit të borxhit shtetëror.

KREU VII GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË

Neni 34 Natyra e garancisë shtetërore të huasë

Garancia shtetërore e huasë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin, por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë.

Garancia shtetërore e huasë konvertohet në borxh shtetëror pas përcaktimit nga Ministri i Financave se pagesa apo pagesat e papaguara për huanë, për të cilën është dhënë garancia, nuk janë bërë në përputhje me kushtet dhe afatet e huasë, duke shkaktuar në këtë mënyrë mospërbushjen e detyrimit të huamarrësit. Veprimi që ndërmerret për pagesën e këtij detyrimi, evidentohet nëpërmjet një dokumenti zyrtar të Ministrisë së Financave, i cili pohon se kushtet për pranimin e dhënies së pagesës së garancisë janë plotësuar.

Neni 35

Sigurimi i garancisë shtetërore të huasë

Në rast se emetimi i garancisë shtetërore të huasë është autorizuar në bazë të ligjeve të tjera, procedurat e përcaktuara për emetimin e këtyre huave vazhdojnë të zbatohen, me kusht që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha kërkesat për hua, të arkivuara në përputhje me ligjet e mëparshme, t'u nënshtrohen një rishikimi përfundimtar dhe miratimi nga Ministri i Financave. Ministrinë e tjera dhe autoritetet përfaqësuese të shtetit, që deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë qenë të autorizuar të japin garanci shtetërore të huasë, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të dorëzojnë në Ministrinë e Financave një informacion të plotë për të gjitha garancitë e papaguara, të emetuara.

Çdo huamarrës, që kërkon marrjen e një garancie shtetërore të huasë, në bazë të këtij ligji, paraqet një kërkesë me shkrim, e cila shoqërohet me dokumentacionin ekonomik dhe financiar, për t'i mundësuar Ministrinë të Financave të vlerësojë kushtet financiare dhe aftësinë e pagimit nga huamarrësi.

Neni 36

Shqyrtimi dhe analiza e garancisë

Kur dokumentacioni mbështetës i kërkesës për një garanci shtetërore të huasë nuk është i plotë, kërkesa, së bashku me dokumentacionin kthehen për t'u plotësuar. Kur dokumentacioni është i plotë, Ministri i Financave, në bazë të analizës ekonomiko-financiare të materialeve, është i detyruar që, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, të shpallë vendimin për dhënien e garancisë.

Neni 37

Vlerësimi i riskut

Analiza ekonomiko-financiare, e përmendur në nenin 36 të këtij ligji, përfshin një përcaktim të riskut që merr përsipër shteti, në rast se jepet garancia. Ministria e Financave mund të kërkojë asistencën e Bankës së Shqipërisë, për të përcaktuar dhe vlerësuar riskun.

Në rastin e garancive shtetërore të huasë, të dhëna në monedhë të huaj, informacioni mbi sasinë e riskut vlerësohet në monedhën kombëtare, sipas kursit të këmbimit të monedhës apo monedhave të huaja, në të cilën/cilat do të bëhet pagesa e garancisë.

Neni 38

Dhënia e garancisë shtetërore të huasë

Ministri i Financave miraton dhënien e garancisë shtetërore të huasë pasi shqyrton dokumentet e mëposhtme:

- a) projekt marrëveshjen e huasë ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;

- b) projekt marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;
- c) marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar nga huamarrësi.

Nënshkrimi i marrëveshjes së garancisë dhe i marrëveshjes së mirëkuptimit bëhen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 39

Dokumentacioni i garancisë shtetërore të huasë

Ministria e Financave është e detyruar të ruajë të gjitha marrëveshjet e huasë, marrëveshjet e garancisë dhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të miratuara në bazë të këtij ligji. Ministria e Financave ka detyrim ligjor të marrë në dorëzim dhe të ruajë të gjitha dokumentet që ndodhen në ministrinë dhe institucionet shtetërore, në bazë të të cilave janë dhënë garancitë shtetërore të huasë, huatë e të cilave janë ende të papaguara.

Ministria e Financave mban të dhëna të veçanta përmbledhëse për garancitë shtetërore të huasë në regjistrin e garancive shtetërore të huasë, në përputhje me këtë ligj.

Neni 40

Mbikëqyrja nga Ministria e Financave

Ministria e Financave kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci shtetërore të huasë. Ministria e Financave u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

Neni 41

Përfundimi i garancisë shtetërore të huasë

1. Garancia shtetërore e huasë përfundon kur:
 - a) huaja, për të cilën është dhënë garancia, është shlyer tërësisht nga huamarrësi;
 - b) afati i garancisë, siç specifikohet në marrëveshjen e garancisë, ka kaluar;
 - c) pagesa i është bërë institucionit huadhënës, në përputhje me afatet e garancisë.
2. Ministri i Financave dokumenton përfundimin e garancisë.

Neni 42

Pagesa për një garanci shtetërore të huasë

Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrin të Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë.

Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 43

Kthimi i garancisë shtetërore të huasë

Me kryerjen e pagesës në llogarinë e garancisë shtetërore të huasë institucionit huadhënës, Ministri i Financave merr në dorëzim të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte institucioni huadhënës ndaj huamarrësit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, në masën e çdo pagese të

bërë në kuadër të garancisë së dhënë. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë Ministrin të Financave, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit.

Huamarrësi, në zbatim të këtij ligji dhe të marrëveshjes së mirëkuptimit, është i detyruar t'i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huasë.

Ministri i Financave ndërmerr të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfutur nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të.

KREU VIII ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE

Neni 44 **Centralizimi i të dhënave**

Ministri i Financave mbledh dhe administron të dhënat e plota dhe të sakta të të gjitha detyrimeve, që kanë të bëjnë me borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë. Të gjitha ministritë apo institucionet e tjera qendrore, të cilat kanë të dhëna të tilla, marrin masa për kalimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Neni 45 **Regjistrat shtetërorë të të dhënave**

Për administrimin e të dhënave për borxhin shtetëror dhe për garancitë shtetërore të huasë, Ministria e Financave krijon dy regjistra:

- a) regjistrin e borxhit shtetëror;
- b) regjistrin e garancive shtetërore të huasë.

Neni 46 **Regjistri i borxhit shtetëror**

Regjistri i borxhit shtetëror përmban të dhëna për borxhin shtetëror, të emetuar në formën e titujve të shtetit dhe borxhin në formën e marrëveshjeve të huasë. Regjistri i borxhit shtetëror mund të përmbajë edhe kategori të tjera të dhënash, sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e miratuar nga Ministri i Financave.

Ky regjistër përmban edhe informacion për detyrimet ekzistuese, në monedhën vendase apo monedha të huaja, si dhe për vlerësimet e detyrimeve fillestare dhe korrente në monedhë vendase dhe në monedha të huaja.

Regjistri i borxhit shtetëror përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Ministria e Financave dhe botohet një herë në tre muaj.

Neni 47 **Regjistri i garancive shtetërore të huasë**

Regjistri i garancive shtetërore të huasë përmban informacion, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e miratuar nga Ministri i Financave.

Në këtë informacion përfshihen të dhënat e identifikimit të secilës garanci huaje, sipas huamarrësit, institucionit huadhënës, shumës së huasë, monedhës dhe gjendjes së huasë, të regjistruar çdo gjashtë muaj.

Huamarrësi depoziton pranë Ministrisë së Financave, në datën 15 të çdo muaji, informacionin e nevojshëm për gjendjen dhe lëvizjen e fondeve të huasë së garantuar.

Regjistri i garancive shtetërore të huasë përditësohet, në mënyrë të vazhdueshme, nga

Ministria e Financave dhe botohet një herë në tre muaj.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48
Fusha e veprimit të ligjit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për shumën e përgjithshme të borxhit shtetëror të emetuar, si dhe për të gjitha garancitë shtetërore të huasë, të kontraktuara nga Ministria e Financave, në përputhje me ligjet që kanë qenë në fuqi përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Borxhi i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni vlerësohet borxh shtetëror dhe, si i tillë, përbën detyrim ligjor të ekzekutueshëm nga Ministria e Financave dhe gëzon të njëjtin trajtim me borxhin dhe me garancitë shtetërore të huasë, që do të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 49
**Informacioni për garancitë shtetërore të huasë të dhëna
para hyrjes në fuqi të ligjit**

Ministri i Financave u kërkon të gjitha ministrive dhe organeve qeverisëse të shtetit dhe institucioneve të tjera, që kanë dhënë më parë garanci shtetërore të huasë, të paraqesin, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të dhënat për të gjitha garancitë e papaguara, përfshirë edhe kërkesat për garanci që janë në shqyrtim. Kopjet e marrëveshjeve të huasë, për të cilat janë dhënë garanci, dokumentacioni mbështetës dhe informacioni për gjendjen korrente të pagesave të huave të papaguara i dërgohen Ministrisë së Financave. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin e garancive shtetërore të huave.

Neni 50
Përfaqësimi i Ministrit të Financave

Secila dhe çdo referencë ndaj Ministrit të Financave në këtë ligj është referencë për çdonjërin, i cili është duke vepruar si Ministri i Financave dhe një referencë e tillë do të përfshijë çdo zyrtar në rolin e ministrit gjatë mungesës së tij. Veprimet e ndërmarra nga autoriteti në rolin e Ministrit të Financave do të vlerësohen të njëjta me veprimet e ndërmarra nga vetë ministri dhe nuk do të jetë i nevojshëm asnjë delegim formal i autoritetit.

Neni 51
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 16, 17, 20, 21, 31, 39, 47 e 49 të këtij ligji.

Neni 52
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5180, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9667, datë 29.12.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.7796, DATË 17.2.1994 "LIGJI

MINERAR I SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Minierave” zëvendësohet me emërtimin “Struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare.”.

Neni 2

Në fund të nenit 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Monitorim postminerar” nënkupton një proces për vëzhgimin dhe kontrollin e ndryshimit të parametrave fiziografikë, kimikë, gjeoteknikë, si dhe për vlerësimin e efekteve të mundshme të shfrytëzimit mineral, pas mbylljes ose braktisjes së një miniere.”.

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 16 ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është enti i specializuar, i cili siguron asistencë teknike për ministrinë, nëpërmjet opionencave, monitorimeve dhe veprimtarive të tjera, që kanë lidhje me këtë ligj.”.

Neni 4

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Veprimtaria minerare, në tërësi, që lidhet me projektimin, vlerësimin, këshillimin, monitorimin dhe drejtimin teknik të shoqërive, kryhet nga specialistë të pajisur me leje nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 99, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c. zonat minerare, veprimtaria minerare e të cilave vlerësohet e përfunduar apo e braktisur, kalojnë në procesin e monitorimit postminerar. Mënyra dhe kriteret për realizimin e këtij procesi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5183, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9668, datë 18.12.2006

PËR EMIGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË PËR MOTIVE PUNËSIMI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Ky ligj rregullon marrëdhëniet në fushën e emigrimit, për qëllime punësimi ose formimi profesional nëpërmjet punës të shtetasve shqiptarë, që largohen nga Republika e Shqipërisë.

2. Qëllimi i këtij ligji është përkujdesja, mbrojtja, ruajtja e identitetit kombëtar të shtetasve shqiptarë, mbajtja dhe forcimi i lidhjeve të tyre me vendlindjen gjatë kohës që janë të punësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ky ligj synon:

- a) menaxhimin e proceseve emigratore;
- b) mbrojtjen e të drejtave politike, ekonomike dhe sociale të emigrantëve;
- c) parandalimin e emigrimit të parregullt dhe të trafikimit të qenieve njerëzore, duke zgjeruar kanalet e emigrimit të rregullt;
- ç) rritjen e bashkëpunimit me partnerët socialë, OJF-të e njohura ligjërishit, vendase dhe të huaja dhe agjencitë private të punësimit.

3. Në çdo rast, shteti shqiptar garanton të njëjtën mbrojtje, si për shtetasit që ndodhen brenda territorit të tij, ashtu dhe për shtetasit shqiptarë që ndodhen përkohësisht të punësuar jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emigrim për motive punësimi” është largimi me dëshirë i shtetasit shqiptar nga territori i Republikës së Shqipërisë për t’u punësuar, vetëpunësuar, për t’u formuar profesionalisht nëpërmjet punës në një shtet tjetër ose për t’u ribashkuar me pjesëtarin e familjes që ka emigruar.

2. “Emigrant” është personi që është, ka qenë apo do të jetë i punësuar ose i vetëpunësuar, në mënyrë të rregullt, në një veprimtari fitimprurëse, jofitimprurëse ose veprimtari publike, me ose pa kufizim kohor, në një shtet të ndryshëm nga ai i shtetësisë së tij/saj.

3. “Emigrant i parregullt” është shtetasi shqiptar emigrant, i cili nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat e vendosura nga shteti pritës për hyrjen, tranzitin, qëndrimin dhe ushtrimin e një veprimtarie fitimprurëse, jofitimprurëse ose publike në territorin e këtij shteti.

4. “Emigrant afatgjatë” është emigranti, i cili qëndron jashtë shtetit për një periudhë kohore

më të gjatë se një vit.

5. “Emigrant afatshkurtër” është emigranti, i cili qëndron jashtë shtetit për një periudhë kohore më të shkurtër se një vit.

6. “Shteti shqiptar” janë të gjitha autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe institucionet e tjera shtetërore, të cilat mund të lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me aspektet e punësimit, të formimit profesional nëpërmjet punës, punësimit ndërkufitar, punësimit sezonal, si dhe me aspektet e përkujdesjes ndaj shtetasve shqiptarë gjatë emigrimit.

7. “Emigrim i rregullt” është lëvizja e një personi nga territori i Republikës së Shqipërisë në një vend tjetër, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë daljen nga vendi i origjinës, udhëtimin, tranzitin, hyrjen dhe qëndrimin në vendin pritës.

8. “Menaxhim i emigrimit” është procesi i hartimit, i harmonizimit dhe zbatimit të politikave, përmirësimeve ligjore dhe administrative të vendeve të origjinës dhe të vendeve pritëse.

9. “Autoritete shtetërore përgjegjëse” janë ministritë e përmendura shprehimisht në dispozitat e këtij ligji, si dhe çdo strukturë tjetër në varësi të tyre, që mbulojnë çështjet e trajtuara nga ky ligj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti kryesor koordinues për zbatimin e këtij ligji.

10. “Punësim ndërkufitar” është punësimi i shtetasve shqiptarë, që lëvizin nga territori i Republikës së Shqipërisë në territorin e zonave kufitare të një shteti fqinj me Republikën e Shqipërisë, për ushtrimin e veprimtarive të punësimit, në bazë të kontratave, me kusht që të rikthehen në vendbanimin e tyre të përhershëm çdo ditë ose të paktën një ditë në javë, duke ruajtur vendbanimin e tyre të përhershëm në vendin e origjinës.

11. “Punësim stinor” është punësimi i shtetasve shqiptarë, që kryhet vetëm gjatë një periudhe të vitit dhe në varësi të kushteve stinore.

12. “Punëdhënës” është çdo shtetas, shqiptar ose i huaj, me seli brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka nënshkruar një kontratë pune me emigrantin shqiptar.

13. “I vetëpunësuar” është emigranti, i cili ka qenë, është ose do të angazhohet në një veprimtari fitimprurëse, duke siguruar jetesën nëpërmjet kësaj veprimtarie, duke punuar, vetëm ose bashkë me pjesëtarët e familjes, si dhe çdo emigrant tjetër, i përcaktuar si i vetëpunësuar nga legjislacioni i shtetit ku ai është punësuar nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

14. “Emigrant i rikthyer” është emigranti shqiptar i rikthyer në Republikën e Shqipërisë, për t’u larguar përsëri ose jo, pasi ka kaluar të paktën një vit në shtetin pritës dhe ka qëndruar të paktën një vit në Republikën e Shqipërisë. Të tillë janë edhe refugjatët e riatdhesuar, me dëshirë apo me detyrim, viktimat e trafikimit, të miturit, të burgosurit e luftës dhe diplomatët në kohë krizash.

15. “Shtet pritës” është shteti ku është ose do të punësohet një shtetas shqiptar, pavarësisht nga lloji i kontratës së punës.

16. “Regjistri për emigrantët” është dokumenti zyrtar në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që përmban të dhëna të hollësishme për shtetasit shqiptarë, të punësuar jashtë shtetit ose që shprehin dëshirën të punësohen, të formohen nëpërmjet punës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe emigrantët shqiptarë të rikthyer.

17. “Kurse formimi orientuese” janë kurset për formim profesional, gjuhësor dhe njohuri të tjera, për të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve emigrantë, si dhe për kulturën dhe kushtet e punës në vendin pritës, në territorin e Republikës së Shqipërisë, para nisjes, deri në tri javë, intensive, vetëm për shtetasit, që kanë siguruar një kontratë pune jashtë vendit dhe janë në pritje të largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe për pjesëtarët e familjes së tyre, që do të emigrojnë apo do të ribashkohen me ta.

18. “Statusi i emigrantit” është dokumenti zyrtar, i miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që u jepet shtetasve shqiptarë emigrantë, që plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj.

19. “Informacion i rremë” është çdo informacion i pasaktë për procesin e emigrimit dhe ofertat për punësim, kushtet e punës, shpërblimin, formimin dhe punësimin aktual në vendin pritës.

20. “Emigrantë të kualifikuar” janë shtetasit shqiptarë, që kanë marrë një gradë akademike, që kanë formim apo përvojë të mjaftueshme për vendin e punës, për të cilin paraqesin kërkesë, siç

përcaktohet nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si autoriteti shtetëror përgjegjës.

21. “Trafikim” është prokurimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kalimi i paligjshëm në një shtet palë të një personi, në të cilin ai nuk është shtetas apo rezident i përhershëm.

22. “Kontrabandim” është ndërmjetësimi për të arritur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, përfitim financiar ose përfitim tjetër material, nga hyrja e paligjshme e një personi në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke shkelur legjislacionin përkatës.

Neni 3

Politikat shtetërore të emigrimit

1. Shteti shqiptar menaxhon emigrimin e shtetasve shqiptarë, duke e vlerësuar atë si një zgjedhje të individit dhe në respekt të lirisë së lëvizjes së lirë të shtetasve.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse krijojnë lehtësi ligjore dhe administrative, të nevojshme për shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të ligjshme ose që dëshirojnë të rikthehen.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse krijojnë lehtësi ligjore dhe administrative, të nevojshme për menaxhimin e emigrimit, nëpërmjet informimit periodik, publik ose individual, për situatën ligjore dhe ndryshimet që mund të jenë bërë në shtetet pritëse, për punësimin dhe formimin profesional.

4. Autoritetet shtetërore përgjegjëse mbështesin punësimin ndërkufitar të shtetasve shqiptarë, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 4

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Subjekte të këtij ligji janë shtetasit shqiptarë, të cilët:

a) kanë emigruar në mënyrë të rregullt dhe janë punësuar ose vetëpunësuar e që qëndrojnë në një vend të huaj;

b) nuk janë larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë, por janë regjistruar pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse, organizatave dhe agjencive private dhe publike të punësimit në Republikën e Shqipërisë, që organizojnë punësimin jashtë vendit, si kandidatë të mundshëm për të emigruar për punësim apo formim profesional nëpërmjet punës, jashtë vendit, ose që kanë marrë leje qëndrimi/pune dhe janë në prag të largimit;

c) janë rikthyer në Republikën e Shqipërisë nga shteti pritës pas përfundimit të kontratës së punës;

ç) janë rikthyer vullnetarisht ose me detyrim në Republikën e Shqipërisë nga shteti pritës, ngaqë kanë qenë pa dokumentacionin përkatës ose në një situatë të parregullt, në zbatim të marrëveshjeve të ripranimit, të nënshkruara ndërmjet Republikës së Shqipërisë, vendeve pritëse dhe të tranzitit, si dhe të marrëveshjes së ripranimit me Komunitetin Europian.

2. Gjithashtu, janë subjekte të këtij ligji edhe studentët, të cilët, gjatë periudhës së studimeve, kanë qenë ose janë në marrëdhënie pune, sipas legjislacionit të vendit pritës.

KREU II

TË DREJTAT E PUNËTORËVE EMIGRANTË SHQIPTARË

Neni 5

E drejta për të emigruar

1. Në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe me parimet e përgjithshme të akteve ndërkombëtare, të detyrueshme për t'u zbatuar nga Republika e Shqipërisë, çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të emigrojë nga territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni shtetasi shqiptar duhet ta ushtrojë në përputhje me këtë nen.

3. E drejta e parashikuar në pikën 1 të këtij neni kufizohet vetëm në rastet kur cenohet siguria kombëtare, shëndeti dhe morali publik, të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe kur ka një vendim gjykate të formës së prerë.

4. Çdo shtetas shqiptar gëzon të drejtën e mundësive dhe të trajtimit të barabartë për të emigruar, pa dallim race, ngjyre, seksi, etnie, besimi fetar, bindjeje politike apo origjine sociale.

Neni 6

Liritë dhe të drejtat politike

1. Emigrantët shqiptarë gëzojnë liritë dhe të drejtat politike, të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi, si dhe duke marrë pjesë aktive në jetën politike të vendit.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse krijojnë lehtësitë e nevojshme për emigrantët shqiptarë, që të ushtrojë të drejtën e votës, duke respektuar dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor dhe legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 7

E drejta e përfaqësimit të emigrantëve

Emigrantët shqiptarë, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të organizatave dhe shoqatave të tyre, kanë të drejtë të kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të shtetit shqiptar, si dhe me përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë në vendet pritëse, për të shprehur dhe mbrojtur interesat e tyre, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 8

E drejta për të përfituar nga shërbimet shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse ose agjencitë private të punësimit duhet t'u sigurojnë shtetasve shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë, përfshirë edhe emigrantët e rikthyer, të drejtën e informimit dhe të këshillimit falas në fushën e formimit profesional, të shërbimeve të ndërmjetësimit për punësim, të mbrojtjes sociale, të organizimit në sindikata, të mundësive për strehim, arsimim dhe sigurime shoqërore, si dhe të njohjes së kushteve të jetesës e të punës në vendin pritës, nëpërmjet mjeteve mediatike, broshurave etj.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ndihmon në organizimin e kurseve të formimit orientues, pa pagesë, për mësimin e gjuhës ose të njohurive bazë për profesionet e kërkuara nga shteti pritës për shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të emigrojnë, si dhe për pjesëtarët e familjes së tyre, që do të emigrojnë apo do të ribashkohen me ta, me kusht që të jenë të regjistruar në "Regjistrin për emigrantët".

Neni 9

Pagesat doganore dhe taksat

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse përjashtojnë nga pagesat doganore dhe taksat emigrantët

shqiptarë, që kanë fituar statusin e emigrantit të rikthyer në shtetin e origjinës, për:

a) sendet vetjake dhe pronësitë e luajtshme të punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjes, që i përkasin njësisë familjare;

b) një sasi veglash dore dhe pajisjesh të lëvizshme, të nevojshme për profesionin që do të ushtrojnë.

2. Përrjashtimet e mësipërme do të zbatohen në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU III DETYRIMET E SHTETASVE SHQIPTARË QË DËSHIROJNË TË EMIGROJNË

Neni 10

Detyrimi për t'iu përmbajtur motivit të punësimit

1. Emigrantët në vendet pritëse kanë detyrimin t'i përmbahen motivit të punësimit, për të cilin kanë emigruar.

2. Kalimi në situatë të parregullt, si dhe kryerja e veprave dhe e kundërvajtjeve penale në vendin pritës vlerësohen vepra të dënueshme penalisht, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 297 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Dokumentacioni për punësim

Shtetasit shqiptarë që kërkojnë të emigrojnë, përveç dokumentacionit, që kërkohet në bazë të legjislacionit të vendeve pritëse, duhet të kenë një kontratë pune me punëdhënësin, si dhe pasaportën ose një dokument të vlefshëm udhëtimi, të pranuar nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë dhe i shtetit pritës, me vizë hyrëse të shtetit pritës.

Neni 12

Regjistrimi i shtetasve

Çdo shtetas shqiptar, që kërkon të emigrojë për qëllime punësimi, si dhe emigrantët e rikthyer regjistrohen në "Regjistrin për emigrantët" pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Forma, përmbajtja e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 13

Përfitimi i statusit të emigrantit

1. Përfiton statusin e emigrantit çdo emigrant i regjistruar në "Regjistrin për emigrantët", që ka:

a) depozituar një kontratë pune, të nënshkruar nga palët;

b) dokumentin përkatës, i cili vërteton statusin e tij si i vetëpunësuar në vendin pritës;

c) dokumentin, që provon se është pjesëtar i familjes së njëres prej kategorive migratore, të sipërpërmendura në këtë nen.

2. Forma, përmbajtja e dokumentit dhe procedurat për përfitimin e statusit të emigrantit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

KREU IV DETYRIMET E AUTORITETEVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE

Neni 14

Respektimi i lëvizjes së lirë

Shteti shqiptar nuk e kufizon emigrimin për qëllime punësimi. Autoritetet shtetërore përgjegjëse ndihmojnë dhe lehtësojnë integrimin e emigrantëve të punësuar në vendet pritëse, duke zbatuar detyrimet që rrjedhin nga konventat, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 15

Respektimi i parimit të barazisë gjinore

Autoritetet shtetërore përgjegjëse respektojnë dhe nxisin parimin e mundësive të trajtimit të barabartë gjinor të emigrantëve shqiptarë gjatë të gjitha fazave të procesit të emigrimit, veçanërisht gjatë fushatave publicitare ose informuese, rekrutimit, mundësive për punësim, mbrojtjes së të drejtave të tyre jashtë vendit, si dhe gjatë kthimit, nga subjekte shtetërore dhe private.

Neni 16

Ndalimi i trafikimit

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse parandalojnë dhe marrin të gjitha masat për të eliminuar trafikimin dhe kontrabandimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse shqiptare dhe ato të vendeve pritëse bashkëpunojnë për bashkërendimin dhe harmonizimin e instrumenteve ligjore, për parandalimin dhe reduktimin e trafikimit dhe të kontrabandimit të shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

3. Të miturit, që nuk kanë mbushur moshën për punë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, nuk mund të largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë për motive punësimi, me përjashtim të rasteve kur largimi është për motive formimi profesional nëpërmjet punës.

4. Autoritetet shtetërore përgjegjëse hartojnë dhe zbatojnë politika për mbrojtjen dhe sigurimin e ndihmës për viktimat e trafikimit.

Neni 17

Mosdiskriminimi i emigrantëve shqiptarë

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse verifikojnë dhe ndërhyjnë për respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse, në zbatim të instrumenteve ndërkombëtare, të ratifikuara nga këto vende, për nënshkrimin dhe zbatimin e kontratës së punës, në rastet e diskriminimit të padrejtë, të pajustificuar apo arbitrar.

2. Punëtorët migrantë gëzojnë trajtim të njëjtë me shtetasit e vendeve pritëse për kushtet e punës, pagesën e sigurimeve shoqërore, anëtarësinë në sindikata, pavarësisht shtetësisë, racës, seksit dhe besimit fetar.

Neni 18

Botimi i ofertave për punësim

Autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe agjencitë private të punësimit botojnë, brenda 30 ditëve nga miratimi zyrtar, ofertat e shteteve pritëse për shtetasit shqiptarë për punësim, formim nëpërmjet punës, punësim sezonal e punësim ndërkufitar.

Neni 19

Informacioni i rremë

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse ndalojnë propagandimin dhe përdorimin e informacionit

të rremë nga çdo subjekt, sipas dispozitave të Kodit Penal, kur veprimtaria e mësipërme përbën vepër penale.

2. Agjencitë private të punësimit, si dhe çdo subjekt, vendas apo i huaj, i interesuar për qëllime punësimi, formimi profesional nëpërmjet punës, punësimi stinor ose punësimi ndërkuftar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të marrë një miratim zyrtar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përpara se t'i bëjë publike ofertat përkatëse.

Neni 20

Ruajtja e lidhjeve ndërkomunitare

Autoritetet shtetërore përgjegjëse mbështesin ngritjen, zhvillimin dhe forcimin e komuniteteve të emigrantëve jashtë vendit, duke konsoliduar veprimtaritë e ndërmarrja nga klube, organizata dhe shoqata, me synim forcimin e lidhjeve ndërmjet tyre dhe me vendin e origjinës.

Neni 21

Arsimimi i emigrantëve

Autoritetet shtetërore përgjegjëse përkujdesen për krijimin e kushteve për arsimimin e emigrantëve dhe të familjarëve të tyre, për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe të trashëgimisë kombëtare, si dhe të lidhjeve shpirtërore ndërmjet komuniteteve të emigrantëve, duke respektuar legjislacionin e shtetit pritës, si dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 22

Nxitja e rikthimit të emigrantëve

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse nxisin rikthimin e vullnetshëm të emigrantëve, të kualifikuar dhe të pakualifikuar, për përfitim të aftësive të reja profesionale dhe kulturore, nëpërmjet hartimit të programeve të veçanta, në bashkëpunim me biznesin vendas, OJF-të vendase dhe të huaja, me donatorët e ndryshëm dhe shtete të tjera pritëse të interesuara.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse nxisin dhe mbështesin riintegrimin e emigrantëve në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale dhe zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, të punësimit dhe të formimit profesional nëpërmjet punës. Masat dhe strukturat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Lehtësitë administrative

Autoritetet shtetërore përgjegjëse lëshojnë dokumentet e kërkuara nga shtetasit shqiptarë, që do të emigrojnë për qëllime punësimi ose formimi nëpërmjet punës, përfshirë edhe emigrantët e rikthyer, duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

Neni 24

Riatdhësimi i detyrueshëm i të miturve

Autoritetet shtetërore përgjegjëse, pasi kanë vënë re ose pasi kanë marrë informacion për punësimin e të miturve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëjnë riatdhësimin e shpejtë dhe pa pasoja, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 25

Përfshirja nga taksat e udhëtimit dhe tarifat aeroportuale

Përfshihen nga taksat e udhëtimit dhe tarifat aeroportuale personat, të cilët kanë përfutur

statusin e emigrantit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 26

Emigrantët e kualifikuar

Për t'i prerë rrugën fenomenit të emigrimit të emigrantëve të kualifikuar, autoritetet shtetërore përgjegjëse ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore dhe masat e nevojshme, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve të veçanta promovuese në fusha të caktuara.

Neni 27

Bashkëpunimi me vendet pritëse

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, për riintegrimin e emigrantëve të rikthyer në Republikën e Shqipërisë, i komunikojnë shtetit pritës të dhënat për:

- a) mundësitë dhe kushtet e punësimit në Republikën e Shqipërisë;
- b) ndihmën financiare të dhënë për riintegrimin ekonomik;
- c) ruajtjen e të drejtave të sigurimeve shoqërore të fituara jashtë shtetit;
- ç) hapat që do të ndërmerren për të lehtësuar strehimin;
- d) barazvlefshmërinë e kualifikimeve profesionale, të fituara jashtë shtetit dhe të të gjitha testeve që duhen kaluar për të siguruar njohjen e tyre zyrtare;
- dh) barazvlefshmërinë e kualifikimeve arsimore të fituara jashtë shtetit, që fëmijët e punëtorëve migrantë të pranohen në shkolla, pa rënë nga niveli.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse bëjnë botimin e këtij informacioni, duke përdorur të gjitha format dhe mjetet e mundshme, në formë të shkruar dhe elektronike.

3. Autoritetet shtetërore përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse të vendeve pritëse për shkëmbimin e informacionit për kushtet e punës, sigurimet shoqërore, anëtarësinë në sindikatat e lira, që lidhen me procesin emigrator.

4. Autoritetet shtetërore përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse të vendeve pritëse për çështjet që lidhen me mbrojtjen shoqërore, në rastet e përfitimeve nga sëmundjet, barrë lindjet, aksidentet në punë, invaliditeti, sëmundjet profesionale, papunësia, ndihma sociale dhe vdekjet.

5. Autoritetet shtetërore përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse të vendeve pritëse për hartimin e kurrikulave të formimit profesional për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të emigrojnë, për njohjen e kualifikimeve profesionale në vendet pritëse.

6. Autoritetet shtetërore përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse të vendeve pritëse për krijimin e lehtësive ligjore dhe administrative, për njohjen e ndërsjellë të diplomave, certifikatave dhe kualifikimeve të tjera të nevojshme, me qëllim lehtësimin e integritit të tyre në këto vende.

Neni 28

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti përgjegjës kombëtar, që harton politikat dhe propozon ndryshime në legjislacionin e fushës së emigrimit për qëllime punësimi dhe ka këto detyra e përgjegjësi:

a) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme menaxhon dhe mbikëqyr të gjitha aspektet e emigrimit për motive punësimi;

b) përgjigjet për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive të zyrave për komentet e punësimit, si dhe për veprimtarinë e agjencive private të punësimit;

c) nëpërmjet strukturave në varësi të saj, në bashkëpunim me ministrinë e tjera dhe organizatat jofitimprurëse, ushtron kompetenca për përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para

largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

ç) në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të fushës, propozon nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera në fushën migratore;

d) nënshkruan marrëveshje, dypalëshe ose shumëpalëshe, në fushën e emigrimit për punësim dhe për formim profesional nëpërmjet punës me ministritë homologe të shteteve pritëse.

Neni 29

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme, në zbatim të këtij ligji, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi për:

a) mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të emigrantëve shqiptarë, kudo qofshin ata, në bashkëpunim me autoritetet e tjera shtetërore të Republikës së Shqipërisë;

b) zgjidhjen e problemeve të emigrantëve shqiptarë, përmes rritjes së cilësisë së shërbimit konsullor në shtetet pritëse;

c) hartimin dhe përcaktimin e programeve të bashkëpunimit me komunitetet emigratore shqiptare;

ç) mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për legjislacionin e punës dhe të mbrojtjes shoqërore, për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve emigrantë;

d) kryerjen e studimeve kërkimore për prirjet e zhvillimit të tregjeve të punës në vendet kryesore pritëse dhe mundësitë e zgjerimit të këtyre tregjeve në ato vende, ku kushtet e trajtimit dhe të punësimit për fuqi emigratore të huaj janë të pranueshme, duke ia bërë të njohura Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

dh) mbështetjen dhe krijimin e shoqatave të emigrantëve shqiptarë në frymën e partneritetit, duke i bërë pjesë aktive në hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe të legjislacionit shqiptar të kësaj fushe;

e) vendosjen dhe fuqizimin e komunikimit me institucionet dhe strukturat përkatëse të vendeve pritëse;

ë) mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve me shtete të tjera për emigrimin për punësim dhe formim profesional nëpërmjet punës.

Neni 30

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Brendshme

1. Ministria e Brendshme, në zbatim të këtij ligji, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi për:

a) kontrollin e kufijve, për të siguruar emigrimin e rregullt të shtetasve shqiptarë, si dhe marrjen e masave për parandalimin dhe çrrënjosjen e trafikimit të qenieve njerëzore;

b) trajtimin me përparësi për pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm të shtetasve shqiptarë që kërkojnë të emigrojnë;

c) monitorimin e sistemit të regjistrimit dhe të kontrollit kufitar për emigrantët shqiptarë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme;

ç) shkëmbimin e informacionit për numrin, shtetet dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të emigrantëve shqiptarë.

2. Emigrantët, shtetas shqiptarë, të cilët largohen për një kohë më të gjatë se 6 muaj nga vendbanimi i tyre në Shqipëri, deklarojnë vendbanimin dhe kohën e qëndrimit në shtetin ku ato shkojnë në zyrat përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

Neni 31

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të këtij ligji, ushtron këto detyra e përgjegjësi

për:

- a) bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse për ngritjen e qendrave arsimore dhe kulturore shqiptare në këto vende;
- b) bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse për krijimin e kushteve lehtësuese për arsimimin e fëmijëve të emigrantëve;
- c) zbatimin e programeve kombëtare për arsimimin e emigrantëve shqiptarë në shtetet pritëse;
- ç) zbatimin e programeve të përbashkëta me institucionet vendase dhe të huaja për rikthimin vullnetar të studentëve të arsimuar dhe të kualifikuar jashtë vendit;
- d) bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse të shteteve pritëse për njohjen e diplomave dhe të kualifikimeve.

Neni 32

Bashkëpunimi i strukturave shtetërore

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të bashkëpunojnë për:
 - a) shkëmbimin e informacionit për shtetasit emigrantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) hartimin e programeve të përbashkëta për zbatimin e këtij ligji.
 - c) rikthimin e shtetasve shqiptarë;
 - ç) mbikëqyrjen e veprimtarisë së zyrave të punësimit dhe të agjencive private të punësimit;
 - d) krijimin e kushteve konkrete për riintegrimin e emigrantëve shqiptarë në shoqërinë vendase.
2. Bashkëpunimi i autoriteteve shtetërore përgjegjëse për çështjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 33

Krijimi i lehtësive për emigrantët

Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të përmirësojnë legjislacionin përkatës dhe të hartojnë programe kombëtare të veçanta për riintegrimin e shtetasve shqiptarë dhe orientimin e dërgesave të tyre drejt investimeve produktive për zhvillimin e vendit.

Neni 34

Sigurimet shoqërore të emigrantëve

Sigurimet shoqërore të emigrantëve shqiptarë, të punësuar në mënyrë të rregullt, rregullohen në bazë të legjislacionit për sigurimet shoqërore të shtetit shqiptar dhe të shtetit pritës, marrëveshjeve dypalëshe në këtë fushë dhe konventave ndërkombëtare për sigurimet shoqërore, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 35

Fondi i emigrimit

1. Për të përballuar nevojat për krijimin e kushteve dhe të lehtësive të parashikuara në

dispozitat e këtij ligji krijohet fondi i emigrimit. Ky fond krijohet dhe funksionon si zë i veçantë në buxhetin e autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe përdoret për:

a) prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese dhe orientuese për aspektet ligjore, kulturore, etnike të shteteve pritëse, që do t'u ofrohen shtetasve që dëshirojnë të emigrojnë për qëllime punësimi, emigrantëve të rikthyer, si dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, që do të emigrojnë apo do të ribashkohen me to;

b) kurse orientuese formimi gjuhësor dhe profesional;

c) raste të emergjencës, përveç rasteve të parashikuara në ligjin nr.8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore";

ç) riatdhesimin e shtetasve.

2. Burimet e këtij fondi janë Buxheti i Shtetit, 1 për qind e të ardhurave nga shërbimet që u ofrohen emigrantëve brenda dhe jashtë vendit dhe donacionet e ndryshme.

Neni 36

Dita e emigrantit

Shteti, në respekt të emigrantëve të larguar, cakton datën 2 korrik "Ditën e emigrantit".

KREU V

SHËRBIMET PRIVATE TË EMIGRIMIT

Neni 37

Agjencitë private të punësimit

1. Shteti njeh dhe përkrah veprimtarinë e agjencive private të punësimit që, për qëllime të këtij ligji, ka të bëjë me:

a) shërbimet për informimin, këshillimin, si dhe për vlerësimin e kërkesave e të aplikimeve për ndërmjetësim për punësim;

b) kërkimin e vendeve të punës;

c) shërbimet që lidhen me ndërmjetësimin ndërmjet punëkërkuesve dhe punëdhënësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa qenë palë e marrëdhënies të punësimit që mund të lindin nga ky ndërmjetësim;

ç) trajnimin e punëkërkuesve, për t'i bërë ata të përshtatshëm për subjektet fizike ose juridike të shteteve pritëse;

d) bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me autoritetet shtetërore përgjegjëse, për ofrimin e informacionit të nevojshëm e për zhvillimin e kurseve formuese, orientuese;

dh) shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe autoritetit shtetëror përgjegjës për numrin e shtetasve të regjistruar në "Regjistrin për emigrantët";

e) përfitim të një kuote të përcaktuar për punësimin e shtetasve shqiptarë, në rastet kur Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i vihen në dispozicion kuota të veçanta nga shtetet pritëse. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pas vlerësimit të veprimtarisë së agjencive private të punësimit, përcakton kuotat për agjencitë e përzgjedhura.

2. Kushtet e përzgjedhjes së agjencive dhe kuotat përkatëse miratohen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 38

Detyrimet e agjencive private të punësimit

1. Agjencitë private të punësimit përkujdesen në çdo kohë për shtetasit shqiptarë, për të cilët

ato kanë qenë ndërmjetësuese për punësimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për respektimin e kushteve të kontratës, mosdiskriminimin dhe respektimin e të drejtave të tyre.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse hartojnë programe trajnimi për stafin e agjencive private të punësimit. Tarifat e këtyre shërbimeve miratohen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 39

Njoftimi i autoritetit shtetëror përgjegjës

1. Agjencia private e punësimit, në fund të çdo 6-mujori, i dërgon me shkrim Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të dhëna për shtetasit shqiptarë, për të cilët ka ndërmjetësuar për punësim jashtë vendit dhe çdo informacion tjetër të kërkuar për veprimtarinë e tyre.

2. Agjencitë private të punësimit njoftojnë autoritetet shtetërore përgjegjëse, kur vërejnë ose vihen në dijeni se nuk respektohen dispozitat ligjore të shtetit pritës ose aktet ndërkombëtare.

Neni 40

Parandalimi i veprimtarive të jashtëligjshme

Autoritetet shtetërore përgjegjëse, kur vërejnë ose marrin dijeni se agjencia private e punësimit ka ndërmjetësuar punësimin ose formimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, nëpërmjet praktikave mashtruese, ngarkojnë organet e përcaktuara me ligj për të vlerësuar veprimtarinë e kësaj agjencie.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 41

Shtetasit shqiptarë, që kanë emigruar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohen në “Regjistrin për emigrantët” në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 42

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 43

Shfuqizime

1. Ligji nr.9034, datë 20.3.2003 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, shfuqizohet.

2. Çdo akt nënligjor, në zbatim të ligjit të mësipërm, që nuk bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, vazhdon të jetë në fuqi deri në daljen e akteve të reja.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5181, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2 Objekti

Ky ligj ka si objekt:

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.
3. “Pjesëtarë të familjes” janë:
 - a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues;
 - b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
 - c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën “b”;
 - ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;

- d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit;
dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.
4. “Viktimë“ është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
5. “Dhunues/e” është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.
7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Neni 4 **Subjektet**

Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjithë personat e cilësuar në nenin 3 pika 3 të këtij ligji.

KREU II ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5 **Autoritetet përgjegjëse**

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:
 - a) njësitë e qeverisjes vendore;
 - b) Ministria e Brendshme;
 - c) Ministria e Shëndetësisë;
 - ç) Ministria e Drejtësisë.

Neni 6 **Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës**

- Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:
- a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
 - b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;
 - c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme, që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, përfshi këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale, sipas legjislacionit në fuqi;
 - ç) organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale, që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;
 - d) mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;
 - dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;
 - e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;
 - ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe

dhunuesit.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:
 - a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;
 - b) trajnimin e efektivave e policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.
2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të ofruar ndihmë mjekësore për dhunën në familje në shërbimet e urgjencës dhe në qendrat shëndetësore në bashki dhe komuna:
 - a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;
 - b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;
 - c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;
 - ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;
 - d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.
3. Ministria e Drejtësisë ka këto detyra:
 - a) të trajtojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;
 - b) të trajtojë përmbaruesit në detyrën e tyre për të ekzekutuar urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, të sigurojë përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23 pika 6, si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura;
 - c) të financojë mbrojtje ligjore falas, sipas parashikimeve në ligj dhe të sigurojë një numër të caktuar avokatësh të trajnuar, që mund të japin një asistencë të tillë.
4. Njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë, komunat) kanë këto detyra:
 - a) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;
 - b) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;
 - c) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përmbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.
3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:
 - a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;
 - b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese

dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;

c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;

ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.

5. Personat të cilët marrin dijëni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.

6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

1. Në rast të dhunës në familje, viktimja mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III

MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

1. Mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, do të sigurohet me këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimja, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar të paditurit/ës (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e

përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbaues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

gj) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimat dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurit/ës (dhunuesit/es);

k) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;

l) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek apo merr pjesë në të. Nëse i/e padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë, me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendimin e gjykatës, mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të këtij neni.

4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g” të këtij neni, gjykata mban parasysh:

a) nëse arma është konfiskuar, ajo mund të kthehet vetëm pas mbarimit të urdhrin të mbrojtjes dhe marrjes së një urdhri nga gjykata;

b) nëse arma është konfiskuar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, gjykata njofton autoritetin përkatës administrativ, ose pezullon lejen e armës derisa të mbarojë urdhri mbrojtës.

Neni 11

Efektet e urdhrin të mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHRIT TË MBROJTJES

Neni 12

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit gjyqësor, seksioni familjar.

Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktimja;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia / prokuroria.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

- a) prindi ose kujdestari i të miturit;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) të afërmit;
- ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
- d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktimja;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia/prokuroria;
- ç) personi me të cilin viktimja ka marrëdhënie familjare;
- d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimja, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
- dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 14

Forma e kërkesë-padisë

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:

- a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;
- b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i/e padituri/a (dhunuesi/ja) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;

c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;

ç) nënshkrimin e kërkuesit.

2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

3. Për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas.

4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrin të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.

5. Kërkesë-padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 15

Provat në procesin gjyqësor

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:

a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;

b) të paditurin/ën (dhunuesin/en), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;

c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;

ç) përfaqësuesit e policisë;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;

dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;

e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) njoftimin se shkelja e urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, brenda 15 ditëve nga shpallja apo marrja dëjani e tij.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) zyres së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjohen personat në vijim:

a) viktimat, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;

b) dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;

c) prokurori, nëse merr pjesë;

ç) kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;

d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

a) ekzistojnë bazat për të besuar se i/e padituri/a (dhunuesi/ja) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë veprë të dhunës në familje; ose

b) i/e padituri/a (dhunuesi/ja) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose

c) lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën veprë penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditëve nga shpallja apo marrja dijani e tij;

d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.

Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërën prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbarrimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510/e, 516/c e vijues).

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes

Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata:

a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b) refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;

c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21

Ankimi

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimi (përfaqësuesi i saj), dhunuesi/ja ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) lënien në fuqi të urdhrin të mbrojtjes;

b) ndryshimin e urdhrin të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose

c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika1 të këtij ligji nuk vlejné më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

4. Viktimi ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mund të parashtrijë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrihet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrin të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose

b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv që në momentin që shpallet (ose u njoftohet palëve). Gjykata lëshon një urdhër ekzekutimi në të njëjtën kohë që lëshon urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

2. Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbaruesit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisariatet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e

menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikura në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga zyrat e shërbimit përmbartimor, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (nenet 510 e vijues).

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga organet zbatuese të vendimit të gjykatës, siç përshkruhet në pikat 2 dhe 4 të këtij neni, përfshirë dhe të paditurin/ën, të cilëve u komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste, ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin e vendimit të gjykatës zbatohen sanksionet përkatëse të parashikura në nenet 320 e 320/a të Kodit Penal, si edhe sanksionet e parashikuara në nenin 606/3 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24 **Procedimi penal**

Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjyqësor nuk i ndalon palët e interesuara të nisnin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 25 **Aktet nënligjore**

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26 **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5182, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Doli nga shtypi më 18.1.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2007

Çmimi 52 lekë